

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5954
E shtunë, 14 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Haradinaj: FSK-ja po zhvillohet në sigurt

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI LAJÇI | FAQE 4-5

Marrëveshja LV - LDK duhet të bëhet



Ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka shprehur optimizëm se marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës do të arrihet. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se një gjë e tillë është në interes të vendit, prandaj edhe marrëveshja duhet të bëhet. Ai e ka kritikuar LDK-në për kërkesat në këto bisedime. Sipas Lajçit, partia e Isa Mustafës duhet të

jetë më fleksibile në këto bisedime dhe të mos ndalet në disa poste. Zyrta i LV-së ka treguar se posti i presidentit të ardhshëm është duke e vështirësuar marrëveshjen në mes të këtyre dy subjekteve politike

OPINION

A MOS NA ERDHI MINISHENGENI NGA QIELLI?! F. 8



Nga Agron HOTI

AKTUALE

PARTITË, JOTRASPARENTE RRETH FINANCIMIT TË FUSHATËS F. 7

THAÇI PRITET NGA PRINCI ALBERT II, E FALËNDERON PËR PËRKRAHJEN NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE F. 5




EKONOMI

KOMISIONI EVROPIAN SHPËRBLËN MINISTRINË E FINANCEVE ME MBI 11 MILIONË EURO F. 9

KIESA U NDAN MIRËNJOHJE 21 NDËRMARRJEVE F. 9

KULTURË



PËRURORHET LIBRI I AUTORIT BEHRAM HOTI 'DASHURIA PËR VATËR E PËR ATDHE NUK SHUHET KURRË' F. 20



Kërkohet anulimi i grevave për aq kohë sa zgjatë pezullimi i Ligjit për paga

FAQE 3

Punëtorët e arsimit dhe ata të shëndetësisë të premtën kanë mbajtur grevë disaorëshe, mjekët i kanë trajtuar vetëm rastet urgjente, kurse mësuesit nuk kanë mbajtur mësim në dy orët e para. Por, disa shkolla

nuk e kanë përfillur vendimin e SBASHK-ut për grevë. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se duhet të anulohet çdo grevë apo protestë për aq kohë sa zgjatë pezulli-

mi i Ligjit për paga. Për grevën e mbajtur të premtën ka reaguar edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili ka thënë se një projektligj i ri për pagat do të ishte zgjidhja më ideale

Zyrtarët e LV-së dhe të LDK-së thonë se ka avancim drejt arritjes së marrëveshjes

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Zaevi: Do të mendojmë seriozisht për koalicionin me BDI-në



Shkup, 13 dhjetor - "Kur VMRO-DPMNE dorëzon 9.000 dhe BDI 5.000 amendamente, dhe mund të bllokojnë ndonjë proces. Ata kanë të drejtë sipas rregullores. Ne do të vazhdojmë të luftojmë, por nuk e di sa do të mundemi. Shpresoj që të ketë shumicë që t'i miratojmë ato vendime. Në frymën e

demokracisë jemi të ndryshëm, ne jemi për një njësi zgjedhore, ndërkaq partneri ynë qeveritar është kundër dhe mund ta lë që VMRO-DPMNE të bllokojë. Megjithatë amendamentet dërgojnë porosi të keqe", tha Zaevi, njofton rtk. Grupi i deputetëve të BDI-së

ka dorëzuar mbi 5.000 amendamente për ndryshimin e Kodit Zgjedhor, ndërkaq Artan Grubi ka premtuar se ndryshimet e njëanshme të legjislatives zgjedhore përpara zgjedhjeve janë precedent i rrezikshëm me pasoja të cilat për momentin nuk mund të vlerësohen.

VMRO-DPMNE-ja opozitare ka qëndrim të ngjashëm, por më pak amendamente. Deputetët e partisë opozitare kanë dorëzuar gjithsej 1200 amendamente edhe atë 600 për propozim-ligjin për modelin zgjedhor dhe 600 për propozim-ligjin për listat zgjedhore.

Zgjedhjet në Britani, fitore historike e Boris Johnsonit

Sipas rezultateve paraprake partia e Boris Johnsonit ka fituar 363 vende në parlamentin prej 650 vendesh duke lënë prapa Laburistët e Jeremy Corbyn me 203 vende. Johnson e cilësoi fitoren e tij më të madhen që nga vitet e 80-ta, kur konservatorët drejtoheshin nga Margaret Thatcher



që të jetë shumë më e madhe dhe më fitimprurëse se çdo marrëveshje që mund të bëhej me BE-në", shkroi presidenti Trump duke përgëzuar kryeministrin Johnson.

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, tha të premtën se Bashkimi Evropian "pret që sa më parë Parlamenti britanik të votojë Brexit-in. Është me rëndësi që të ketë qartësi", tha ai.

Ligjvënësi gjerman, Norbert Roettgen, nga radhët e partisë së kancelares gjermane Angela Merkel, shkroi se "nuk është fshehtësi që unë doja që Mbretëria e Bashkuar të mbetet në BE. Por qytetarët britanikë vendosën dhe duhet të pranojmë zgjedhjen e tyre. Me fitoren e Johnsonit, Brexit-i është bërë i pashmangshëm. Qëllimi ynë tani është t'i mbajmë sa më të ngushta marrëdhëniet me Mbretërinë e Bashkuar", shkroi ai.

LONDËR, 13 DHJETOR - Partia Konservatore e kryeministrit Boris Johnson, fitoi shumicën e vendeve në Parlamentin britanik, një rezultat vendimtar i zgjedhjeve të mbizotëruara nga Brexiti, që do t'i mundësojë kryeministrit t'i përmbushë planet e tij për largimin e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian, muajin e ardhshëm.

Sipas rezultateve paraprake partia e Johnsonit ka fituar 363 vende në parlamentin 650 vendesh duke lënë prapa Laburistët e Jeremy Corbyn me

203 vende.

Kryeministri Johnson e cilësoi fitoren e tij më të madhen që nga vitet e 80-ta, kur konservatorët drejtoheshin nga Margaret Thatcher, ka njoftuar voa.

Duke folur para mbështetësve të tij në Londër, ai tha se qeveria tani ka një shumicë të mjaftueshme në parlament për të përmbushur Brexit-in.

"Kjo do të thotë që jetësimi i Brexit-it është bërë tani vendim i pakundërshtueshëm, i pandryshueshëm për popullin britanik", tha Johnson.

Zgjedhjet ishin humbje e thellë

për udhëheqësin e së majtës, Jeremy Corbyn, i cili u përball me thirrjet për dorëheqjen e tij ndërsa rezultatet po publikoheshin.

Ai i cilësoi rezultatet si "shumë dëshpëruese" dhe tha se nuk do të drejtojë partinë në zgjedhjet e ardhshme, ndonëse kundërshtoi thirrjet për dorëheqje të menjëhershme.

Pas fitores së kryeministrit Boris Johnson, kanë pasuar reagimet ndërkombëtare.

Presidenti amerikan, Donald Trump, tha se fitorja e kryeministrit Johnson do të thotë se Britania dhe Shtetet e Bashkuara do të kenë mundësi të arrijnë një marrëveshje të madhe tregtare pas Brexit-it.

"Kjo marrëveshje ka mundësitë

Konferenca e donatorëve për tërmetin mbahet në Tiranë



TIRANË, 13 DHJETOR - Këshilli i Evropës ka njoftuar se konferenca e donatorëve për t'u ardhur në ndihmë të prekurve nga tërmeti në Shqipëri do mbahet në Tiranë. Presidentja e KiE, Ursula von der Leyen tha të premtën se konferenca do mbahet në fillim ose në mes të janarit dhe se mori mbështetjen e menjëhershme të të gjitha shteteve anëtare.

"Është gjë e mirë që ramë dakord për një konferencë donatorësh për Shqipërinë në Tiranë në fillim të janarit ose në mes të

janarit. Ishte inkurajuese të shihnim mbështetjen e menjëhershme të shteteve anëtare për të qenë përkrah shqiptarëve", tha ajo.

Edhe Rama reagoi në lidhje me këtë temë. "Është një lajm i shumë dëshiruar marrja e vendimit të Këshillit Evropian për mbajtjen e Konferencës së donatorëve në Tiranë, në fund të muajit janar apo në fillim të muajit shkurt, me qëllim mbështetjen e programit të rindërtimit nga të gjitha shtetet

anëtare të BE-së.

Mbajtja e premtimit që mora nga shumë prej liderëve evropianë për këtë konferencë të domosdoshme, më mbush me energji e me optimizëm për suksesin e përpjekjes që të dalim të gjithë më të fortë nga kjo tragjedi, duke nisur nga motrat e vëllezërit tanë fatkeq, të cilët duhet t'i rikthejmë në shtëpi më të mira sesa ato që humbën, si edhe nga fëmijët e tyre, të cilëve do t'u bëjmë shkollat më të mira nga ato që kishin", shkroi Rama.

Vuçiqi: Ne i besojmë Macronit

Beograd, 13 dhjetor - Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq ka thënë se vendi i tij i beson presidentit francez Emmanuel Macron dhe i shprehu mirënjohje Francës për mbështetjen ndaj Serbisë në rrugën e saj evropiane.

Vuçiqi tha në një konferencë për shtyp me ministren franceze të Mbrojtjes, Florence Parly, se Serbia nuk po merr pjesë në një fushatë pothuajse të orkestruar kundër Macronit mbi disa vendime të BE-së,

përkatesisht vendimin për të mos hapur bisedimet e anëtarësimit në bllok të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, ka njoftuar rtk.

Ai theksoi se kur bëhet fjalë për një metodologji të re në pro-

cesin e zgjerimit të BE-së të iniciuar nga Franca, i mbetet Serbisë të pres dhe se është i bindur që presidenti francez Emmanuel Macron nuk do ta harrojë Serbinë ose nuk do ta lërë atë vetëm.



Kërkohet anulimi i grevave për aq kohë sa zgjatë pezullimi i Ligjit për paga

Punëtorët e arsimit dhe ata të shëndetësisë të premten kanë mbajtur grevë disaorëshe, mjekët i kanë trajtuar vetëm rastet urgjente, kurse mësuesit nuk kanë mbajtur mësim në dy orët e para. Ndërkaq disa shkolla nuk kanë përfillur vendimin e SBASHK-ut për grevë. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se duhet të anulohet çdo grevë apo protestë për aq kohë sa zgjatë pezullimi i Ligjit për paga. Për grevën e mbajtur të premten ka reaguar edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili ka thënë se një projektligj i ri për pagat do të ishte zgjidhja më ideale



Oda Mjekëve të Kosovës ka mbështetur grevën e sindikatave të shëndetësisë të mbajtur të premten. "Oda e Mjekëve të Kosovës me këtë rast shpreh solidarizimin e plotë me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës për të gjitha aktivitetet dhe veprimet sindikale të arsyeshme, përfshirë këtu edhe grevën si një nga mjetet e ligjshme të veprimit sindikal. Prandaj, duke marrë parasysh mundësitë kushtetuese dhe ligjore, si dhe kapacitetet profesionale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, kërkojmë që kërkesën e Avokatit të Popullit, përkitazi me vlerësimin e kushtetueshmërisë të Ligjit për paga në sektorin publik, ta trajtojë me urgjencë dhe përparësi ndaj të gjitha lëndëve të tjera, gjithnjë duke marrë parasysh rrethanat dhe situatën e rëndë ekonomike, sociale dhe politike e, po ashtu, pritjet legjitime të të punësuarve në sektorin publik të Kosovës", është bërë me dije në reagimin e Odës së Mjekëve të Kosovës.

Rreth 82 mijë persona që paguhën nga buxheti i shtetit të Kosovës do ta marrin pagën e njëjtë, pa rritje, deri në muajin mars të vitit të ardhshëm. Shumë nga ta kanë pritur t'i marrin rrogat me rritje, por një gjë e tillë nuk do të ndodhë, pasi Gjykata Kushtetuese, pas kërkesës së parashtruar nga Avokati i Popullit, të enjten e ka pezulluar zbatimin e ligjit.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), nëpërmjet një reagimi për media, ka theksuar të premten se duhet të pezullohet çdo grevë apo protestë për aq kohë sa zgjatë pezullimi i Ligjit për paga. KMDLNj shpreson dhe beson se për shkak të natyrës së punës, Federata Sindikale e Shëndetësisë dhe Sindikata e Policisë nuk do të bëjnë grevë të përgjithshme për faktin se seriozisht do të rezikohet shëndeti i qytetarëve të Kosovës, siguria e qytetarëve dhe stabiliteti i Kosovës.

Për SBASHK-un, KMDLNj-ja ka theksuar se në vend se të marrë përgjegjësi për rezultatet katastrofale në testin e PISA-s, me grevën e paralajmëruar, në mënyrë aktive po kontribuon në degradimin e sistemit arsimor duke legalizuar në këtë mënyrë analfabetizmin funksional. "KMDLNj ia përkujton opinionit dhe udhëheqësve sindikalistë, se masa e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, pezullimi deri më 30 mars 2020 nuk është vendim përfundimtar dhe nuk e paragjykon vendimin final, prandaj propozon që derisa të zgjasë masa e pezullimit për zbatim të Ligjit për pagat në sektorin publik, të pezullohen të gjitha grevat dhe protestat e paralajmëruara nga sindikatat dhe pjesërisht të realizuara. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës janë të pakundërshtueshme dhe asnjë

grevë apo protestë nuk e vë në pyetje këtë vendim, qoftë si masë e përkohshme apo vendim final. Askush nuk ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese edhe kur janë shkarkuar presidentët, kur janë kundërshtuar marrëveshjet me Serbinë apo edhe Asociacioni i Komunave Serbe në Kosovë. Edhe sindikatat e lartpërmendura nuk kanë asnjë arsye ta kundërshtojnë masën e pezullimit nga Gjykata Kushtetuese deri në një vendim final. Nëse ligji shpallet antikushtetues nuk do të zbatohet fare dhe nëse jo, do të ketë kompensim në mënyrë retroaktive", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Punëtorët e arsimit dhe ata shëndetësorë mbajnë grevën

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka bërë me dije, nëpërmjet një njoftimi për media, se në shumicën absolute, gjegjësisht në mbi 98 për qind të institucioneve arsimore të premten është mbajtur greva dyorëshe. "Nga raportet shihet se nga 1 116 institucione arsimore parauniversitare, gjegjësisht nga 784 shkolla amë dhe 332 paralele të ndara, në grevë ishin 1 101, ndërsa pjesërisht apo plotësisht në grevë nuk kanë marrë pjesë vetëm 15 sosh. Bazuar nga raportet që vijnë në selinë e SBASHK-ut nga kryetarët e nivelit komunal sindikal, shihet se shumica absolute e institucioneve

arsimore kanë respektuar vendimin e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut për grevën paralajmëruese dyorëshe. Nga raportet shihet se nga 1 116 institucione arsimore, gjegjësisht nga 784 shkolla amë dhe 332 paralele të ndara, në grevë ishin 1 101, ndërsa pjesërisht apo plotësisht në grevë nuk kanë marrë pjesë vetëm 15 sosh", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut. Sipas këtij njoftimi, Këshilli Grevist qendror, bashkë me këshillat greviste komunale, po e përcjell situatën dhe nëse merren informacione shtesë, se edhe ndonjë institucion arsimor kudo në Kosovë nuk ka respektuar vendimin e Këshillit Drejtues, do ta informojnë opinionin.

Edhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, respektivisht Këshilli Qendror Grevist,

ka njoftuar se greva kishte filluar në orën 07:00 ashtu siç ishte planifikuar në të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës. "Të gjithë punëtorët i janë përgjigjur grevës së përgjithshme, përveç në QKMF - Shtime u informuam nga nënkryetarja e sindikatës në këtë qendër, znj. Shehrije Morina, se ka ndodhur një incident, ku një qytetar ka thyer një xham në laboratorin e kësaj qendre mjekësore, me të cilin rast tani për tani është duke u marrë Policia e Kosovës. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës do t'ju mbajë të informuar lidhur me mbarëvajtjen e grevës. Njëherësh, kërkojmë mirëkuptimin nga ana e qytetarëve të Republikës së Kosovës", është thënë në njoftimin e Këshillit Qendror Grevist të FSSHK-së.

Kurti: Kemi nevojë për një projektligj të ri për pagat

Mospajtimet që ka shkaktuar Ligji i pagave do të jenë problemet kryesore me të cilat do të përballet qeveria e re në rast se arrihet koalicioni në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, që është kandidat për kryeministër, ka thënë se do ta presin aktgjykimin e Gjykatës

Kushtetuese dhe varësisht nga ato që thuhet aty, do të shkohet drejt zgjidhjes së situatës, mirëpo, sipas tij, një projektligj i ri që do t'i përmirësonte gabimet do të ishte zgjidhja ideale. "Unë besoj se kemi nevojë për një projektligj të ri, pra që e plotëson dhe e ndryshon këtë aktualin në mënyrë që pabarazitë e ngelura të eliminohen. Të mos harrojmë se edhe me Ligjin

e ri të pagave, shoferi i kryeparlamentarit e ka pagën më të lartë se drejtori i shkollës. Andaj, pabarazitë e ngelura janë të papranueshme dhe duhet të adresohen në një projektligj të ri për paga, të plotësohet dhe të ndryshohet ky aktual, me ç'rast duhet të merren parasysh edhe ato që do të na i thotë Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin e saj", ka thënë Kurti.

Zyrtarët e LV-së dhe të LDK-së thonë se ka avancim drejt arritjes së marrëveshjes

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, janë takuar sërish të premten, ku kanë vazhduar bisedimet për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Pas takimit që ka zgjatuar më

shumë se dy orë, është bërë me dije se të dy liderët kanë shënuar përparim drejt arritjes së marrëveshjes.

Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Avdullah Hoti nga Lidhja Demokratike e Kosovës kanë folur për media pas takimit Kurti - Mustafa që është

zhvilluar të premten në ambientet e Kuvendit të Kosovës.

Avdullah Hoti ka thënë se ky takim ka qenë mjaft konstruktiv për marrëveshjen që pritet të arrihet në mes të dy subjekteve politike. "Jemi pajtuar që t'i vazhdojmë takimet", ka thënë ai. Ndërkaq Glauk Konjufca ka bërë

me dije se në këtë takim janë diskutuar disa mënyra të zgjidhjes së asaj që ka mbetur në gjysmë. "Kemi bërë avancim të pozicioneve tona drejt një marrëveshjeje. U pajtuam që takimet tona të jenë më të shpeshta në të ardhmen", ka thënë ai. Konjufca ka bërë me dije se sot (e

shtunë) sërish do të vazhdojnë takimet mes dy partive. Ai ka thënë se ky takim nuk do të mund të caktohet po sikur pozicionet mos të afroreshin mes këtyre dy partive. "Pra, po shoh se ka një gatishmëri prej të dyja palëve që marrëveshja të arrihet", ka thënë Konjufca.

Flet për "Epokën e re", Ali Lajçi

Marrëveshja LV - LDK

Ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka shprehur optimizëm se marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës do të arrihet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se një gjë e tillë është në interes të vendit, prandaj edhe marrëveshja duhet të bëhet. Ai e ka kritikuar LDK-në për kërkesat në këto bisedime. Sipas Lajçit, partia e Isa Mustafës duhet të jetë më fleksibile në këto bisedime dhe të mos ndalet në disa poste. Zyrtari i LV-së ka treguar se posti i presidentit të ardhshëm është duke e vështirësuar marrëveshjen mes këtyre dy subjekteve politike



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ali Lajçi, ka deklaruar se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) duhet të jetë më fleksibile në bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për arritjen e marrëveshje për qeverinë e re. Ai ka thënë se për shkak të ndryshimeve që i duhen vendit LDK-ja nuk duhet ta kushtëzojë marrëveshjen për disa pozita. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", Lajçi ka shprehur optimizëm për marrëveshjen LV-LDK. "Mendoj se LDK-ja në këto bisedime do të duhej të ishte shumë më fleksibile për shkak të ndryshimeve që kërkohen për vendin. Pra, do të duhej t'i jepet shansi që theksi për ndryshime të bie më shumë kah Vetëvendosja. Nuk do të duhej LDK-ja të frenohej në kuptim të funksioneve apo pozitave. Do të duhej t'i jepej përkrahje një qeverie të tillë, sepse interesat e vendit e duan ashtu", ka

Regjistrohen 119 deputetë të legjislaturës së VII të Kuvendit

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - 119 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës të Legjislaturës VII kanë përfunduar procedurën e regjistrimit në Kuvend sipas kalendarit të përcaktuar nga administrata. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, pas kërkesës së shumicës së partive politike, ka ndryshuar datën e thirrjes së mbledhjes së parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës. "Duke

respektuar kërkesën e shumicës së partive politike që kanë siguruar ulëse në Kuvendin e Kosovës, me sqarimin se data 24 dhjetor lidhet me pushimin për festën e Kërshëndellave, presidenti Thaçi ka vendosur që mbledhjen e parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta thërrasë më datën 26 dhjetor në orën 15:00", është thënë në njoftimin e Presidencës.



duhet të bëhet

thënë Lajçi.

Ai ka bërë me dije se posti i presidentit nuk është dashur të përfshihej në këtë marrëveshje. Sipas Lajçit, përfshirja e këtij posti të lartë në marrëveshje po i rëndon bisedimet në mes të dy partive. "Posti i presidentit nuk do të duhej të përfshihej në këtë marrëveshje, sepse ai vend nuk është mbetur vakant. Tani ka prioritete të tjera, siç është formimi i Kuvendit dhe qeverisë, për çka edhe janë mbajtur zgjedhjet e 6 tetorit. Zgjedhjet nuk janë mbajtur për presidentin, prandaj kjo çështje duhet të diskutohet kur të vijë koha", është shprehur ai. Madje Lajçi ka thënë se LDK-ja duhet të tregohet fleksibile me LV-në edhe në raport me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Sipas tij, partia e Kurtit duhet t'i drejtojë ministrinë nga të cilat varet ndryshimi në vend. "Realisht programi ndryshues për shoqërinë dhe Kosovën është programi i Lëvizjes Vetëvendosje, sepse ky program sjell një alternativë ndryshuese. Në bazë të kësaj Vetëvendosje ishte dashur t'i ketë disa ministri që japin thelbin e ndryshimit, siç është Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministri e Financave, kurse të tjerat mund të udhëhiqeshin edhe nga LDK-ja", ka vlerësuar ai, duke shtuar se modeli qeverisës i LDK-së nuk ndryshon nga modelet e deritashme qeverisëse.

"Epoka e re": Z. Lajçi, pavarësisht prej paralajmërimeve se LV-ja dhe LDK-ja do të merren

vesh së shpejti, ende nuk kemi marrëveshje. Pse mendoni se po ndodh kjo zvarritje?

Lajçi: Përpara modeli i arritjes së marrëveshjeve apo pazareve ka qenë ndryshe. Disave u ka mbetur në kokë ai model. Tash mund të provojnë që të jetë i njëjti, që nuk do të duhej për shkak të ndryshimeve që përgjithësisht duhet të ndodhin. Tani koalicionet duhet të kenë një cilësi tjetër të marrëveshjes. Pra, primar duhet të jetë krijimi i institucioneve, siç është Kuvendi dhe qeveria, sepse Kosova sot ka nevojë shumë për ndryshime dhe partitë politike duhet ta luajnë rolin në drejtimin ashtu si kanë votuar qytetarët e Republikës së Kosovës. Mirëpo disa partive u ka mbetur në kokë modeli i vjetër i pazarit ku vihen në shprehje interesat e ngushta dhe jo ato kombëtare. Mendoj se tani ka ardhur koha të ndryshojë kjo praktikë e vjetër të të bërit të koalicioneve. Marrëveshja në mes të këtyre dy partive duhet të bëhet sa më shpejt.

"Epoka e re": Deri më tani pengesa kryesore për arritjen e kësaj marrëveshje është posti i presidentit. Si e keni parë ju këtë kërkesë të LDK-së?

Lajçi: Posti i presidentit nuk do të duhej të përfshihej në këtë marrëveshje sepse ai vend nuk është mbetur vakant. Tani ka prioritete të tjera, siç është formimi i Kuvendit dhe qeverisë, për çka edhe janë mbajtur zgjedhjet e 6 tetorit. Zgjedhjet nuk janë mbajtur për presidentin,

prandaj kjo çështje duhet të diskutohet kur të vijë koha. Madje mund të shkohet edhe në reformimin e ligjit zgjedhor që ka shumë nevojë. Pas këtij ndryshimi, ndoshta presidenti mund të zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës. Kjo mënyrë e zgjedhjes së presidentit do të ishte larg pazareve të parlamentit. Pra, çështja e postit të presidentit nuk mund të jetë peng për akomodim të individëve të tjerë, të cilët nuk janë edhe aq të denjë për atë punë.

"Epoka e re": Largimi i postit të presidentit prej marrëveshjes, mendoni se do ta lehtësonte arritjen e kësaj marrëveshje?

Lajçi: Sigurisht se po, sepse këto dy parti atëherë do të duhej të merreshin vesh vetëm për qeverinë dhe Kuvendin. Ndërsa, çështja e presidentit duhet të diskutohet kur të vijë koha. Tani për tani kjo çështje është vetëm një ngarkesë për marrëveshjen dhe nuk ka pasur nevojë tani që ajo të jetë si një kushtëzim.

"Epoka e re": Në fakt, të dyja palët kanë pranuar se kanë mospajtime edhe sa i përket çështjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme?

Lajçi: Programi ndryshues për shoqërinë dhe Kosovën është programi i Lëvizjes Vetëvendosje, i cili sjell një alternativë ndryshuese. Në bazë të tij Vetëvendosje ishte dashur t'i ketë disa ministri që japin thelbin e ndryshimit, siç është Ministria e Drejtësisë,

Ministria e Punëve të Brendshme, Ministri e Financave, kurse të tjerat mund të udhëhiqeshin nga LDK-ja. Modeli i qeverisjes së LDK-së është parë dhe ka qenë i njëjtë si ai i PDK-së, AAK-së dhe partive të tjera. Pra, do të duhej t'i jepej një shans Lëvizjes Vetëvendosje edhe me ministrinë të cilat faktikisht e përbëjnë domenin e ndryshimeve në vend.

"Epoka e re": Kemi parë përplasje publike në mes të disa zyrtarëve të LV-së dhe të LDK-së.

Lajçi: Pavarësisht prej qëndrimeve të individëve të caktuar, marrëveshja mes këtyre dy partive duhet të ndodhë, sepse për këtë koalicion qeverisës ka nevojë Kosova dhe do të ishte absurde të mos ndodhin marrëveshjet që i duhen vendit.

"Epoka e re": Nëse për ndonjë arsye nuk ndodh kjo marrëveshje, kush do të duhej të ishte përgjegjës për një gjë të tillë?

Lajçi: Përgjegjësi do të dihet pasi të shikohet se kush çfarë ka dashur në këto bisedime. Mendoj se LDK-ja në këto bisedime do të duhej të ishte shumë më fleksibile për shkak të ndryshimeve që kërkohen për vendin. Pra, do të duhej t'i jepej shansi që theksi për ndryshime të bie më shumë te Vetëvendosja. Nuk do të duhej LDK-ja të frenohej në kuptim të funksioneve apo pozitave. Do të duhej t'i jepej përkrahje një qeverie të tillë sepse interesat e vendit e duan ashtu.

Thaçi pritët nga Princi Albert II, e falënderon për përkrahjen në organizatat ndërkombëtare

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është pritur të premten nga Princi Albert II i Monakos në Pallatin Principal, të cilin e ka falënderuar për përkrahjen për Kosovën. Presidenti Thaçi është shprehur i kënaqur me bashkëpunimin bilateral dhe me përkrahjen e Monakos për Kosovën në skenën ndërkombëtare. "Monako ka përkrahur Kosovën, sidomos në aspiratën për anëtarësim në organizatat

ndërkombëtare, veçanërisht në forumet sportive. Duke përkrahur Kosovën në këto forume keni ndihmuar ndërtimin e paqes dhe pajtimit, në Kosovë dhe në rajon", u shpreh presidenti Thaçi në takim me Princin Albert. Princi Albert II i Monakos është shprehur i lumtur me bashkëpunimin me Kosovën dhe ka shprehur përkrahje për perspektivën euroatlantike të Kosovës. Presidenti Thaçi në takim e njoftoi Princin Albert për të arriturat e Kosovës për ndërtimin e paqes dhe në konsolidimin e shtetit të Kosovës në skenën ndërkombëtare.



Partitë, jotransparente rreth financimit të fushatës



PRISHTINË, 13 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka publikuar pasqyrat e të hyrave dhe shpenzimeve të partive politike gjatë fushatës së fundit për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 6 tetor. Ajo që vërehet, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, është se ka një s'përputhje në mes të të hyrave dhe shpenzimeve. Të gjitha partitë deklarojnë deficit të lartë në shpenzime, por u mungon edhe transparenca rreth burimeve nga i kanë siguruar ato mjete. Betim Musliu nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë për "Radion Evropa e Lirë" se në përgjithësi nuk ka ndryshime politike në rritjen të transparencës për të gjitha shpenzimet e partive politike në financimin e fushatave. Ai thotë se ende ka shpenzime të shumta, të cilat janë parë se janë bërë, por të cilat nuk figurojnë se janë në listat e partive politike. "Rrjedhimisht, ka një mungesë të transparencës dhe llogaridhënës për sa i përket kësaj fushe. Pra, partitë politike vazhdojnë që të jenë ende organizata të mbyllura, të cilat nuk e

tregojnë realitetin për sa i përket shpenzimit të buxhetit", ka thënë Musliu. Në publikimin e të dhënave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpjegohet se subjektet politike, kryesisht ato më të mëdha, Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Partia Socialdemokrate, Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë kanë shpenzuar rreth dy milionë euro. Këto parti kanë deklaruar se kanë pasur të hyra rreth gjysmë milioni euro, nga kjo vlerë rreth 209 mijë euro janë donacione, kurse mbi 250 mijë euro mjete të ndara nga Kuvendi i Kosovës. Në bazë të këtyre të dhënave të paraqitura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, figuron se partitë politike kanë deficit mbi 1.5 milion euro. Përfaqësuesit e shoqërisë civile që e kanë monitoruar procesin zgjedhor, pikërisht te kjo vlerë dyshojnë në mostransparençën e mjeteve të shpenzuara për fushatë, madje kërkojnë burim-

in e këtyre mjeteve. "Pasojat e kësaj mungese të transparencës janë të mëdha, sepse realisht të zgjedhurit e popullit që vijnë nga këto parti politike, përderisa në arritjen e synimeve të tyre nuk janë fare transparentë, atëherë nuk mund të presim edhe një qeverisje të mirë, e cila duhet të jetë e ndërtuar mbi parimet e sundimit të ligjit të qeverisjes së mirë", ka vlerësuar Musliu.

Valmir Elezi, zëdhënës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se me qëllim të rritjes së transparencës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka publikuar dosjen e informimit publik të subjekteve politike dhe të kandidatëve nga fushata e zgjedhjeve të parakohshme që u mbajtën më 6 tetor. Ai ka theksuar se neni 43 i Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme specifikon se KQZ-ja përmes Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim krijon dhe ruan një dosje të informimit publik, e cila përmban regjistrin e donatorëve të secilit subjekt politik, raportet e publikimit financiar

të fushatës së subjekteve politike të dorëzuara në KQZ dhe formularët e publikimit financiar për kandidatët e zgjedhur. "Këto që janë publikuar nuk janë raporte të audituara. Auditimi i raporteve bëhet nga auditorë të cilët i përzgjedh Kuvendi i Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe sigurisht se edhe raportet pas auditimit do të publikohen", ka thënë Elezi.

Rezarta Delibashzade-Krasniqi nga organizata për Demokraci për Zhvillim thotë për "Radion Evropa e Lirë" se është pozitive që KQZ-ja ka publikuar me kohë raportet e shpenzimeve të subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore. Po ashtu, ajo ka thënë se një aspekt që bie në sy nga analiza e raporteve është shuma e vogël e donacioneve rreth 200 mijë euro për pesë subjektet kryesore politike. "Një numër i bizneseve të mëdha japin donacione shumëfish më të larta sesa kufizimet ligjore prej jo më shumë se dhjetë mijë euro brenda vitit, që i shtynë subjektet politike të mos i deklarojnë fare këto shuma të

marra përmes rrugëve joformale. Kjo e bën më të lehtë edhe shpenzimin e tyre pa i respektuar rregullat e prokurimit. Përndryshe, nuk mund të shpjegohet fakti që partitë kanë shpenzuar tri herë më shumë sesa që kanë pasur mjete në dispozicion, dhe kjo vetëm sipas deklarimeve zyrtare ngaqë shumat mund të jenë dukshëm më të larta", ka theksuar Delibashzade-Krasniqi.

Ligji për financimin e partive politike, burimet financiare dhe materiale të subjekteve politike përbëhet nga financimi publik përmes buxhetit të Republikës së Kosovës. Shuma e mjeteve buxhetore, dedikuar fondit për mbështetjen e subjekteve politike, nuk mund të kalojë 0.17 për qind të buxhetit të Kosovës dhe donacionet e tjera. Kurse në bazë të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton maksimumin e shpenzimeve të fushatës, që bazohet në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit nga KQZ-ja.

ShSKUK-ja dhe FSK-ja shtojnë bashkëpunimin

Prishtinë, 13 dhjetor (ER) - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë shtuar

bashkëpunimin. Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Basri Sejdiu, ka pritur në takim general Shkelzen Sylja nga

Forca e Sigurisë së Kosovës, me të cilin ka biseduar lidhur me shtimin e bashkëpunimit ndërmjet ShSKUK-së dhe FSK-së.

Gjatë takimit palët u pajtuan të lidhin një memorandum të bashkëpunimit në të cilin do të specifikohen fushat në të cilat do të fillojë bashkëpunimi.



Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të premten një vizitë pune në Ministrinë e Mbrojtjes

Haradinaj: FSK-ja po zhvillohet sigurt

Me rastin e njëvjetorit të miratimit të Ligjit për Forcën e Sigurisë, të Ligjit për Shërbimin në FSK dhe të Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se ushtarët e FSK-së duhet të ndihen krenarë për rolin dhe përgjegjësinë që kanë në shërbim të vendit e të qytetarëve, pa dallim, të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial si dhe ofrimit të paqes e të sigurisë në vend dhe rajon. Ai ka thënë se ushtria e Kosovës është krenare për rreshtimin e saj në ushtritë e paqes, të botës të prirë nga Amerika. "Duke i takuar këtij rreshti synojmë të aftësohemi që të bëhemi anëtarë të NATO-s në afatin më optimal kohor", ka thënë Haradinaj



kryeministrin në detyrë, Haradinaj, për medaljen e dhënë, duke thënë se kjo nuk është meritë vetëm e tij, por e të gjithë djemve dhe vajzave që shërbejnë në FSK, pa të cilët tha se nuk do të ishin këtu ku janë. "Falë angazhimit, përkushtimit, disi-

plinës dhe profesionalizimit të treguar ne jemi sot këtu. Është edhe një angazhim shtesë për gjithë FSK-në, që në të ardhmen t'i kryejmë detyrat dhe obligimet tona bazuar në mandatin dhe misionin e ri dhe ju siguroj se do të jemi të gatshëm në çdo kohë

për çfarëdo vështirësie që u paraqitet qytetarëve të vendit. Po ashtu, jemi të gatshëm të kontribuojmë edhe në misionet paqeruajtëse", ka thënë gjenerallejtënant Rama, duke theksuar se ky është obligim dhe detyrë e tyre.



Haradinaj bëri homazhe te shtatorja e heroit Mujë Krasniqi

KLINË, 13 DHJETOR (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në 21-vjetorin e rënies së heroit Mujë Krasniqi, ka bërë të premten homazhe dhe ka vendosur kurora me lule te shtatorja e tij në Klinë. Me

këtë rast, kryeministri në detyrë, Haradinaj, duke nderuar heroin Mujë Krasniqi dhe bashkëluftëtarët e tij, tha se ata ranë për ditët që ne i jetojmë sot. "Në vigjilje të 21-vjetorit të përjetësisë, duke u përulur para shtatorës së heroit Mujë Krasniqi,

nderova jetën dhe veprën madhështore të komandant Kapuçit dhe të 40 bashkëluftëtarëve të tij. Në kërkim të lirisë, ata ranë te kufiri që sot nuk ekziston. Ranë për ditët që i jetojmë sot. Lavdi!", ka thënë kryeministri në detyrë, Haradinaj.

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 DHJETOR

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të premten një vizitë pune në Ministrinë e Mbrojtjes, për ta shënuar njëvjetorin e miratimit të Ligjit për Forcën e Sigurisë, të Ligjit për Shërbimin në FSK dhe të Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes. Fillimisht, kryeministri në detyrë, Haradinaj, është prituri nga ministri në detyrë i Ministrisë së Mbrojtjes, Rustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rahman Rama. Me këtë rast, ministri në detyrë, Berisha, i ka dorëzuar kryeministrin në detyrë, Haradinaj, raportin njëvjeçar të punës së Ministrisë së Mbrojtjes, ku përfshihen aktivitetet dhe të arriturat e këtij viti.

Pas takimit, kryeministri në detyrë, Haradinaj, në fjalën kade tëve të FSK-së ka thënë se të shtunën bëhet një vit nga votimi i ligjeve për Ushtrinë e Kosovës, për Ministrinë e Mbrojtjes për Shërbimin Usharak dhe për mandatin e Forcës së Sigurisë, me ç'rast deputetët e Kuvendit votuan unanimisht dhe mandatuan Ushtrinë e Kosovës me detyrën e vet mbrojtëse, në bazë të Kushtetutës së vendit dhe ligjeve në fuqi. "Me këtë ka filluar një epokë e re e mandatit të ushtrisë tonë, njëkohësisht një epokë e re e vendit, si një vend sovran, vend i cili, në bazë të Kushtetutës së vet, ka vendosur t'i japë vetes kompetenca mbrojtëse. Kosova funksionon në partneritet edhe me palët e jashtme, në këtë rast me misionin e NATO-s në Kosovë, si KFOR, mision i cili ka në vete ushtri që janë aleate, ka edhe ushtri që nuk e kanë njohur Kosovën, të vendeve jonjohëse. Por, në këtë rast KFOR-i është mision të cilin Kosova e pranon, e respekton dhe bashkëvepron", u shpreh kryeministri në detyrë, Haradinaj.

Ndër të tjera, Haradinaj ka pohuar se votimi i ligjeve për mandatin e Forcës dhe vetvetiu dhënia e mandatit mbrojtës vetvetes, ka nxjerrë detyra të reja

për të gjithë mekanizmat institucionalë, politikë, veçanërisht për ushtrinë. "Mendoj dhe besoj që sot pas një viti mund t'u premtojmë qytetarëve të Kosovës, partnerëve tanë, që po shkojmë në hapa të sigurt dhe po i arrijmë objektivat e deklaruara në bazë të vendimit të deputetëve. Ne jemi në dinamikën e duhur dhe po ecim sigurt. Për këtë shpreh falënderim për ministrin Berisha, Ministrinë e Mbrojtjes, po ashtu të gjithë oficerët komandues të të gjitha niveleve të prirë nga gjeneral Rama", ka thënë Haradinaj.

Duke folur për objektivat e ushtrisë së Kosovës, kryeministri në detyrë, Haradinaj, tha se, ndonëse jetojmë në Ballkan, ku asnjëherë nuk përjashtohet lufta, "ne dëshirojmë të punojmë që të jemi të zotë të mbrohemi dhe që kurrë të mos vijmë deri te lufta". "Për këtë arsye ne synojmë edhe rreshtimin tonë me ushtritë e paqes, të botës të prirë nga Amerika. Ne i takojmë këtij rreshti dhe aftësohemi të bëhemi anëtar në NATO, në afatin më optimal kohor. Ju jeni kadetë, jeni në rrugëtim e sipër që të formoheni për përgjegjësitë që do t'i mbani në Ushtrinë e Kosovës. Jemi shumë të nderuar për pjesëmarrjen e kadetëve nga Ushtria shqiptare, por edhe kadetëve të tjerë. Ajo që dua t'ju them, ju siguroj se gjithë jetën tuaj do të jeni krenarë për vendimin tuaj që të jeni ushtarakë dhe t'i përballonit sfidat gjatë periudhës sa jeni në akademi dhe t'i shërbeni popullit tuaj", është shprehur Haradinaj. Ai ka shtuar se ushtarët e FSK-së duhet të ndihen krenarë për rolin dhe përgjegjësinë që kanë në shërbim të vendit e të qytetarëve, pa dallim, të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial si dhe ofrimit të paqes e sigurisë në vend e rajon.

Në fund, kryeministri në detyrë, Haradinaj, i dha medaljen "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rahman Rama, me motivacionin për shërbim të shkëlqyeshëm ndaj atdheut. Ndërkaq komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rahman Rama, ka falënderuar

A mos na erdhi minishengeni nga qielli?!



Nga Agron HOTI

Se a ishim apo jo në dijeni për prejardhjen e minishengenit, se a e pranuar apo e kundërshtuar atë nëpër takime të niveleve më të larta me BE-në, shtetet anëtare të saj dhe vendet e rajonit tonë ende problematik, se a vuajmë për protagonizëm personal para çfarëdo konsensusi të domosdoshëm shtetëror, se a jemi apo jo në gjendje t'i përcjellim dinamikën rajonale dhe evropiane që prekin dhe do ta prekin drejtpërdrejt të ardhmen e Kosovës, mbetet më së miri të shihet se sa do të dimë dhe si do t'i qasemi mënyrës së zhblokimit të pozicionit të Kosovës për një integrim të domosdoshëm e të qëndrueshëm rajonal dhe evropian. Bashkëpunimi rajonal dhe fqinjësia e mirë janë parakushtet për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) dhe një nga strategjitë për t'i adresuar sfi-dat me të cilat përballet rajoni i Ballkanit Perëndimor. Këtë e dëshmojnë veprimet e BE-së karshi rajonit tonë që nga viti 1999. Për ta stabilizuar rajonin tonë të trazuar, Gjermania menjëherë pas luftës në Kosovë, pra në vitin 1999, kishte iniciuar Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore. Ndërkohë që BE-ja në vitin 2000 kishte filluar Procesin e Stabilitetit Asociimit. Të dyja këto iniciativa shiheshin si përmbushëse ndaj njëra-tjetërës ashtu sikurse që shiheshin edhe si paralelizma në mes të BE-së dhe shteteve anëtare të saj. Qëllimi i BE-së dhe shteteve të fuqishme të saj ishte që përmes këtyre iniciativave të kontribuohet në rritje të bashkëpunimit në fushat e zhvillimit ekonomik, politik dhe sigurisë për tërë rajonin e Evropës Juglindore, me theks të veçantë Ballkanin Perëndimor. Si pasardhës i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në shkurt të vitit 2008 në Sofje u formua Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (angl. Regional Cooperation Council - RCC-) me Sekretariat në Sarajevë, i cili aktualisht drejtohet nga Majlinda Bregu, ish-ministre e Integritimit Evropian të Shqipërisë. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal gjatë një dekade të ekzistencës është bërë ombrella kryesore dhe prijëse e të gjitha iniciativave rajonale në fushën e bashkëpunimit rajonal për Evropën Juglindore. Gjatë kësaj periudhe ky Këshill (RCC) ka kontribuar në fuqizimin e bashkëpunimit rajonal dhe integrimin euroatlantik të vendeve të Evropës Juglindore duke përshpejtuar konektivitetin e rajonit, dijet dhe mobilitetin, konkurrueshmërinë,

sundimin e ligjit dhe përpjekjet për bashkëpunim në fushën e sigurisë.

Nëse kthehemi ca vite mbrapa, nuk mund të mos e përmendim faktin që menjëherë pas marrjes së postit të presidentit të Komisionit Evropian nga Jean-Claude Juncker në nëntor të vitit 2014, Bashkimi Evropian po përjetonte ditët më të vështira si rezultat i krizës financiare që kishte goditur BE-në dhe tërë globin. Presidenti Juncker kishte deklaruar në vitin 2014 që gjatë mandatit të tij pesëvjeçar "nuk do të kishte zgjerim të BE-së".

Kjo deklaratë në shumë qarqe pati tingëlluar si ndërprerje dhe dekurajim i procesit të Integritimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Për të mbajtur gjallë perspektivën evropiane për rajonin problematik të Ballkanit Perëndimor kishte lindur Procesi i Berlinit i iniciuar nga Gjermania, i cili fillimisht ishte paraparë për periudhën 2014-2018. Përpos Gjermanisë këtu u përfshinë Austria, Franca, Italia, Kroacia, Sllovenia dhe Mbretëria e Bashkuar, kurse nga Ballkani Perëndimor ishin dhe janë gjashtë vendet (Kosova, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Maqedonia).

Qëllimi i Procesit të Berlinit ishte dhe është avancimi i rend-ditës evropiane në tri drejtime: 1) Rritja ekonomike dhe konektiviteti, 2) Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal, dhe 3) Zhvillimi shoqërisë civile dhe konektivitetit njerëz me njerëz. Si Procesi i Berlinit ashtu edhe Pakti i Stabilitetit që hartuar jashtë kornizës së BE-së për zgjerim, por që nga shumë qarqe u panë si procese përmbushëse karshi rend-ditës evropiane dhe procesit të zgjerimit të BE-së. Për më tepër qëllimi ishte që rajoni i Ballkanit Perëndimor të orientohej drejt BE-së e jo kah Rusia, Kina, Turqia dhe Vendet e Golfit, të cilat përmes investimeve dhe masave të buta (soft measures) po mundohen të shfrytëzojnë çfarëdo vakumi të krijuar në rajon.

Për zbatimin Procesit të Berlinit filluan të organizoheshin samite vjetore duke filluar së pari me atë në Berlin në gusht të vitit 2014, pastaj 2015 në Vjenë, 2016 në Paris, 2017 në Triestë dhe 2018 në Mbretëri të Bashkuar. Krahas Samiteve kishte edhe shumë takime të tjera të nivelit më të ultë me karakter rajonal, e tëra kjo për të afruar perspektivën evropiane sa më afër qytetarëve.

Ideja e Zonës Ekonomike Rajonale për Ballkanin Perëndimor

Meqë rajoni Ballkanit Perëndimor vazhdonte të kishte edhe ende ka probleme të theksuara të fqinjësisë dhe bashkëpunimit rajonal jo të mirë, atëherë kjo temë përbente

rend-ditën kryesore të çfarëdo iniciative që mund t'i servohej rajonit. Ideja e minishengenit buron nga ky tundim i pafund i rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili edhe sot ka vështirësi sa i përket bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë. Përvoja e ka dëshmuar që sa më shumë që izolohehen shtetet aq më e tensionuar bëhet situata e përgjithshme dhe aq më e pashpresë bëhet e ardhmja. Prandaj, me kërkesë të gjashtë kryeministrave të vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë Samitit të Triestës në korrik të vitit 2017 është përgatitur Plani i Veprimit Shumëvjeçar për Zonën Ekonomike Rajonale në kontekst të Procesit të Berlinit. Ky plan parasheh integrim ekonomik rajonal në përputhje me kërkesat e parashtruara nga kryeministrat e vendeve të rajonit. Rend-dita që parasheh ky plan përfshinë: promovimin e integritetit të mëtejshëm të tregut rajonal, krijimin e një hapësire rajonale dinamike për investime, lehtësimin e mobilitetit rajonal dhe krijimin e një rend-dite digjitale të integruar. Për të qenë në linjë me Procesin e

Berlinit edhe Bashkimi Evropian në shkurt 2018 kishte miratuar Strategjinë për Ballkanin Perëndimor, e cila, ndër të tjera, parasheh themelimin i Zonës Ekonomike Rajonale (Regional Economic Area - REA) ku do të përfshiheshin të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për të zbatuar këtë strategji, BE-ja kishte filluar një sërë takimesh të nivelit të lartë në rajon. Samiti i parë BE-Ballkan Perëndimor që prej vitit 2003 në Selanik është mbajtur në Sofje në maj 2018, në të cilin përpos strukturave më të larta të BE-së morën pjesë dhe udhëheqësit më të lartë politik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë ata të Kosovës. Vlen të theksohet që Plani i Veprimit Shumëvjeçar për Zonën Ekonomike Rajonale rrjedh nga angazhimet e ndërmarrja në kuadër të kornizës së CEFTA-s dhe Strategjisë për Evropën Juglindore 2020 (South Eastern Europe - SEE 2020) dhe është i bazuar në parimet dhe rregullat e CEFTA-s dhe BE-së të reflektuara në Marrëveshjet Stabilizim Asociim me vendet e rajonit. Ky plan përfshinë zbatimin e veprimeve prej

periudhës 2017 deri në 2020 dhe disa aktivitete deri në vitin 2023. Për të mirëkoordinuar të gjitha iniciativat rajonale, në Samitin e Triestës në vitin 2017 (në kuadër të Procesit të Berlinit), Këshilli për Bashkëpunim Rajonal i është besuar mandati i qartë për të drejtuar dhe koordinuar zbatimin e Planit të Veprimit Shumëvjeçar për Zonën Ekonomike Rajonale (Multi annual Action Plan for a Regional Economic Area MAP-REA). Edhe në Strategjinë dhe Programin e Punës së Këshillit për Bashkëpunim Rajonal 2020-2022 është paraparë zbatimi Plani i Veprimit Shumëvjeçar për Zonën Ekonomike Rajonale duke shërbyer si udhërrëfyes për të afruar procesin e bashkëpunimit rajonal sa më afër qytetarëve.

Ajo që duhet përmendur është se të gjitha iniciativat rajonale janë në përputhje me Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 të OKB-së dhe me objektivat strategjike të BE-së "Drejt një unioni të qëndrueshëm deri në vitin 2030", si dhe reflektojnë angazhimet dhe zhvillimet në rajon në kuadër të Procesit të Berlinit. (Vijon)

Komuna e Deçanit zgjidh problemin e menaxhimit të mbeturinave të amvisërive

DEÇAN, 13 DHJETOR (ER) - Komuna e Deçanit, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Shpëtim dhe Kompania Komunale "Higjiena", në bashkëpunim me organizatën qeveritare GIZ-I gjerman dhe me organizatën joqeveritare në Kosovë, Green Art Center-Prishtina (GAC), në kuadër të projektit për Shërbime të Qëndrueshme Komunale, kanë finalizuar të gjitha përgatitjet për nisjen e operimit për grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë në territorin e Komunës së Deçanit.

Sipas planit dinamik të zhvilluar, sipas zyrtarëve prej komunës dhe kompanisë komunale, gjatë muajit nëntor janë përfunduar të gjitha aktivitetet për sa i përket informimit qytetar dhe regjistrimit të të gjithë klientëve në këtë komunë dhe shtrirja e shërbimit ka vijuar gradualisht në mbi 70 për qind në muajin nëntor dhe 100 për qind gjatë muajit dhjetor. Njëherësh, përmes punës intensive të grupeve punuese në terren janë përfunduar të gjitha aktivitetet përcjellëse për ta shtrirë shërbimin e grum-



bullimit të mbeturinave në të gjithë territorin komunal, ku pritet që 13 fshatrat e mbetur të përfshihen në shërbim prej javës së ardhshme.

Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka treguar se tashmë kjo komunë ka bërë të gjitha parapërgatitjet dhe investimet e nevojshme për kompaninë komunale dhe është e gatshme për ta përmblyllur me sukses kapitullin e ofrimit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave për të gjithë banorët e Komunës së Deçanit, me qëllim ndryshimin e pamjes mjedis-

ore në këtë komunë. Ai ka falënderuar banorët e Deçanit për bashkëpunimin në këtë reformë ambicioze për këtë komunë.

Përfaqësuesja e GAC-it, Beu-Mucaj, ka thënë se zbatimi i reformave në menaxhimin e mbeturinave komunale prej anës së Komunës së Deçanit jep shembullin më të mirë që ka ardhur koha për ta zgjidhur çështjen e menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal duke ndërmarrë veprime konkrete që krijojnë parakushte për një mjedis të qëndrueshëm e të pastër.

Kosova dhe Shqipëria thellojnë bashkëpunimin në sektorin e energjisë

Prishtinë, 13 dhjetor (ER) - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) e Republikës së Kosovës dhe Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Kjo është marrëveshja e dytë, pas asaj të nënshkruar në vitin 2013, që rregullatorët e të dy vendeve po nënshkruajnë me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe përshtatjes me rrethanat e reja të krijuara në sektorin e energjisë. Me këtë

rast, ushtruesi i detyrës së kryesuesit të Bordit të ZRRE-së, Arsim Janova, ka theksuar se kjo është një ditë e rëndësishme për të dy rregullatorët pasi që, siç ka thënë ai, po rikonfirmohet qëllimi i përbashkët i të dy rregullatorëve për ta vazhduar bashkëpunimin edhe në të ardhmen, duke pasur parasysh se edhe deri më tani ka ekzistuar një bashkëpunim mjaft i mirë në mes të dy institucioneve. Po ashtu, Petrit Ahmeti, kryetar i

Bordit të ERE-së, e ka cilësuar bashkëpunimin në mes të dy rregullatorëve me zanafillë të mëhershme, por që me ndryshimin e rrethanave duhet t'i përmbajë edhe vlerësimet e kohës dhe të rrethanave sa iu përket ndryshimeve që ndodhin në sektor. Ai me këtë rast ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm edhe bashkëpunimin e dy operatorëve të tregut të energjisë të të dy vendeve, OST dhe KOSTT, të cilët, siç ka theksuar ai, kanë bërë



hapa shumë domethënës jo vetëm përmes bashkëpunimit në mes tyre, por edhe me pjesëmarrjen në tregun rajonal.

Komisioni Evropian shpërblen Ministrinë e Financave me mbi 11 milionë euro



PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Ministria e Financave është shpërblyer të premten për punë të mirë nga Komisioni Evropian, me shumën e mjeteve prej 11,499,970.00 euro si mbështetje direkte buxhetore. Këtë shumë të mjeteve Ministria e Financave e ka pranuar pas një pune të madhe për të vendosur dhe mbajtur një stabilitet makroekonomik të vazhdueshëm të vendit, duke

zbatuar me sukses dhe profesionalizëm politika kredibile makro-ekonomike të orientuara drejt stabilitetit. "Menaxhimin e suksesshëm të Financave Publike, përmes implementimit me përpikëri të programit dhe strategjinë për përmirësimin e Menaxhimit të Financave Publike si dhe në të njëjtën kohë duke e rritur transparencën buxhetore për të gjithë të interesuarit, duke përfshirë edhe

shoqërinë civile dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, si dhe ka implementuar me sukses Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës 2016-2020 dhe Modernizimit të Administratës Publike", është thënë në komunikatën e MF-së. Sipas kësaj ministrie, të gjitha këto detyra janë vlerësuar pozitivisht nga Komisioni Evropian, ku është çmuar puna që

është bërë edhe për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit, duke përfshirë edhe respektimin e rregullave fiskale të parapara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. "Për këto arsye sot shteti i Republikës së Kosovës në aspektin financiar qëndron më së miri që ka qëndruar ndonjëherë në të gjithë parametrat e tij", është theksuar në komunikatën e Ministrisë së Financave.

KIESA u ndan mirënjohje 21 ndërmarrjeve

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), përkatesisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në kuadër të aktiviteteve "Ditët e biznesit të vogël 2019", ka mbajtur konferencën informuese për zhvillimin e sektorit privat në Prishtinë, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet qendrore dhe lokale, ATK-ja, Dogana, KEDS-i, si dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit.

Gjatë konferencës u diskutua për sfidat e sektorit privat si dhe për shërbimet dhe programet zhvillimore që ofrohen nga institucionet qendrore.

Nol Buzhala, ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të KIESA-s, ka folur për shërbimet dhe përkrahjen e KIESA-s për ndërmarrjet. Ai ka përmendur aktivitetet e KIESA-s për mbështetjen e ndërmarrjes së

cilat janë realizuar gjatë vitit 2019, si: subvencionimi i ndërmarrjeve, krijimi i zonave ekonomike, organizimi i panireve, forumeve me qëllim të promovimit të kompanive kosovare. Kurse Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve, ka prezantuar aktivitetet e AKB-së në mbështetje të prodhimeve vendore. Në konferencë prezantuan edhe përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) dhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrjes (MIN). Po ashtu, u zhvillua edhe dialog me bizneset pjesëmarrëse të cilat parashtuan pyetje rreth çështjeve që ndërliken me veprimtarinë që ato ushtrojnë. KIESA u ka ndarë mirënjohje për 21 ndërmarrjet në kategoritë mikro, të vogla dhe të mesme nga regjioni i Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Ferizajt, Gjilanit dhe Gjakovës. Në fund të pranishmit vizituan standat e bizneseve në të cilat u ekspozuan produktet vendore.



Ministria e Bujqësisë përkrah dhe promovon bujqësinë organike

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Prodhimtaria bujqësore organike vitet e fundit ka filluar të përkrahet edhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Përmes programeve mbështetëse, MBPZHR-ja i përkrah kultivuesit e prodhimeve organike, ku ndër vite ka pasur edhe rritje të sipërfaqeve të kultivuara me këto produkte. Për rëndësinë e bujqësisë organike dhe zbatimit të Ligjit për Bujqësinë Organike, Njësia për të



Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, në bashkëpunim me Departamentin e Prodhimtarisë Bujqësore dhe

Tregtisë në MBPZHR, kanë organizuar një punëtori, në të cilën kanë marrë pjesë fermerë nga rajone të ndryshme të Kosovës. Me këtë rast, fermerëve u është prezantuar mbështetja e ministrisë ndër vite për këtë sektor, rëndësia e kultivimit të këtyre prodhimeve si dhe metodat më të mira të kultivimit. Koordinatorja e NjDNj-së në MBPZHR, Emine Kelmendi, ka theksuar se objektivi strategjik i ministrisë është garantimi i rrit-

jes së sasisë dhe cilësisë së prodhimit organik me qëllim të garantimit të rritjes së cilësisë së jetesës për konsumatorët. Ndër të tjera, ajo ka folur edhe për rëndësinë që ka zbatimi i Ligjit për Bujqësinë Organike për zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të këtij sektori. Ministria e Bujqësisë përmes pagesave direkte prej 500 eurosh për hektar mbështet sipërfaqet e kultivuara me produkte organike.

Shërbyesit civilë të komunës së Mitrovicës mirëpresin pezullimin e Ligjit për paga

MITROVICË, 13 DHJETOR (ER) - Drejtuesit e Sindikatës së Shërbyesve Civilë të Komunës së Mitrovicës kanë mbajtur një takim për të diskutuar në lidhje me pezullimin e Ligjit për paga nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë takim të pranishmit kanë shprehur qëndrimet e tyre, duke thënë se e përkrahin dërgimin e Ligjit për paga në Gjykatën Kushtetuese sepse,

sipas tyre, ky ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës ka qenë diskriminues në krahasim me shërbimet e tjera në Kosovë. Ata kanë thënë se presin që me amendamentimin e ligjit shërbyesit civilë të kategorizohen në nivelin e njëjtë me shërbyesit e tjerë si shëndetësia, arsimit etj. Kryetari i kësaj sindikate, Mehmet Bajrami, ka thënë se për kërkesat dhe nevojat e shër-

byesve civilë kanë pasur takime dhe premtime nga niveli qendror dhe komisioni qeveritar, që kërkesat e tyre të merren parasysh dhe të jenë të barabarta me shërbyesit civilë të tjerë. Mirëpo, ai ka deklaruar se asnjëri nga këto premtime nuk është plotësuar dhe ndihen të diskriminuar sa i përket kategorizimit në Ligjin për paga.



Nënkryetari Lushtaku shikon punimet në rrugët e fshatrave Rezallë, Plluzhinë dhe Likovc

Skenderaj, 13 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se me përkushtim të madh janë duke vazhduar realizimin e projekteve të ndryshme që kanë burimin nga kërkesat e qytetarëve. "Në kuadër të kësaj, nënkryetari

Nuredin Lushtaku, së bashku me drejtoreshën e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, inxhinierë dhe profesionistë, kanë dalë në terren për ta parë nga afër zhvillimin e punimeve të rrugëve në fshatrat Rezallë, Plluzhinë dhe Likovc", ka thënë të premten Jashari.



Komuna e Kamenicës përmbyllë kampanjën '16 ditët e aktivizimit të dhunës ndaj gruas'

KAMENICË, 13 DHJETOR (ER) - Për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, Komuna e Kamenicës i është bashkangjitur kampanjës globale botërore "16 ditët e aktivizimit të dhunës ndaj gruas", kampanjë kjo të cilën e kanë shënuar 1 700 organizata të ndryshme ndërkombëtare, në 100 shtete të botës.

Komuna e Kamenicës, për hir të kësaj dite, në krye me zyrtaren për Barazi Gjinore, Teuta Kastrati dhe Grupin e Grave të Kamenicës, ka organizuar disa aktivitete. Së bashku kanë vizituar Stacionin Policor në Kamenicë, përkatësisht Njësinë e Dhunës në



Familje, ku janë marrë shënime sa iu përket statistikave të lajmëruara të dhunës në komunë. Po ashtu, zyrtarja për barazi gjinore, Teuta Kastrati, ka organizuar takime me gra në

shkollat fillore të fshatit Karaçevë të Poshtme dhe të Epërme në Roganë dhe Kamenicë, ku ka prezantuar disa statistika në tre vjetët e fundit të dhunës në Kamenicë.

Ferizaj përfiton një automjet, donacion nga Agjencioni i Pyjeve



FERIZAJ, 13 DHJETOR (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se ka përfituar donacion një automjet nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës. "Performanca e lartë e dëshmuar e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, në mbrojtje të pyjeve dhe efikasiteti në këtë betejë kundrejt prerësve ilegalë, me mbështetjen e drejtpërdrejtë e të rezervë të kryetarit të komunës Agim Aliu, përveç mirënjohjes, ka tërhequr edhe vëmendjen e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe Zyrës Rajonale të kësaj agjencie. Për këtë sot, me përkrahjen e kryeshefit të kësaj agjencie, Ahmet Zejnullahu dhe drejtorit të Zyrës Regionale, Bekim Topalli,

drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Burim Bajrami, pranoi donacion një automjet, i cili do të shërbejë që të arrihen distancat dhe të shtohet efikasiteti i punës në terren për mbrojtjen e pyjeve", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Mirënjohës dhe falënderues për këtë donacion është shprehur drejtori komunal i Bujqësisë dhe Pylltarisë, Burim Bajrami. Ai ka thënë se ky donacion, por edhe përkrahja e vazhdueshme që i jepet kësaj drejtorie, edhe nismave të qeverisjes lokale për kujdesin dhe mbrojtjen e ambientit, janë dëshmi që të mbrohet pasuria natyrore.

Nënshkruhet vendimi për subvencionimin e 201 familjeve skamnore për blerjen e drunjve

Prishtinë, 13 dhjetor (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se kryetari Shpend Ahmeti ka nënshkruar vendimin që të ndajë subvencione për blerjen e drunjve për ngrohje për 201 familje me situatë të rëndë socio-ekonomike. "Pak ndih-

më për ata që kanë nevojë shumë. Kryetari Shpend Ahmeti ka nënshkruar vendimin, që përmes Drejtorisë së Mirëqenies të ndajë subvencione për blerjen e drunjve për ngrohje për 201 familje me situatë të rëndë

socio-ekonomike. Të gjitha këto familje janë pjesë e skemës së asistencës sociale dhe shpresojmë se kjo ndihmë do t'ju ndihmojë dhe lehtësojë sadopak jetesën në këta muaj të ftohtë të dimrit", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Turqia kundër rezolutës amerikane për gjenocidin armen

ANKARA, 13 DHJETOR - Ministria e Jashtme e Turqisë tha të premtën se ka thirrur ambasadorin e ShBA-së në Ankara pas një rezolute të miratuar të enjten në mbledhje nga ligjvënësit amerikanë, që i cilëson gjenocid vrasjet e armenëve një shekull më parë. Ministria shprehu keqardhjen e saj për vendimin. Rezoluta u miratua njëzëri nga Senati amerikan. Akti historik e ka

zemëruar Turqinë, duke i dhënë një tjetër goditje marrëdhënieve tashmë të brishta mes dy aleatëve të NATO-s.

Ankaraja e dënoi vendimin, duke e quajtur atë të pavlefshëm si dhe dënoi ligjvënësit amerikanë për atë që ajo e quan "politizim të historisë".

Rezoluta u miratua njëzëri në Senat. Në të konsiderohen si gjenocid vrasja e 1.5 milion

armenëve nga Perandoria Osmane nga viti 1915 deri në vitin 1923.

Dhoma e Përfaqësuesve e udhëhequr nga demokratët, e kishte miratuar rezolutën me një shumicë dërrmuese në muajin tetor. Por votimi në Senat u bllokua në mënyrë të përsëritur nga senatorët republikanë që nga takimi i presidentit Trump me homologun e tij turk më 13 nëntor.



Komisioni i Ligjeve rekomandon ngritjen e akuzave ndaj presidentit Trump

Pa votën e demokratëve, Komisioni i Ligjeve i Dhomës së Përfaqësuesve rekomandoi të premtën ngritjen e akuzave ndaj presidentit Donald Trump, një ditë pas një maratone debati prej 14-orësh të zhvilluar sipas linjave partiake

WASHINGTON, 13 DHJETOR - Komisioni i Ligjeve i Dhomës së Përfaqësuesve rekomandoi të premtën ngritjen e akuzave ndaj presidentit Donald Trump, një ditë pas një maratone debati prej 14-orësh të zhvilluar sipas linjave partiake. Ligjvënësit republikanë bënë që debati rreth dy akuzave të zgjatej, edhe pse nuk kishte ndonjë shpresë se mund t'u merrnin ndonjë votë demokratëve.

Anëtarët e Komisionit të Ligjeve vazhduan përplasjet edhe gjatë orëve të vona të së enjtes, ndërsa republikanët u treguan të vendosur të zgjasnin debatin akuzave ndaj presidentit,

megjithëse nuk kishte ndonjë shpresë se mund fitonin ndonjë votë të demokratëve.

"Abuzim me postin, më jep-të jap, ryshfet. Quajeni çfarë të doni. Në fund të ditës, nuk keni fakte që të mbështesni variantin tuaj", tha ligjvënësi republikan Guy Reschenthaler. "Presidenti Trump gjendet i akuzuar përpara këtij komisioni për shkak të vetë sjelljes së tij, të mënyrës se si veproi me fondet publike dhe postin, me një çështje private dhe një çështje politike. Pra, për të dëmtuar imazhin e kundërshtarit të tij në 2020-ën", tha ligjvënësja demokrate Sheila Jackson Lee. Në akuzën e parë thuhet se



presidenti Trump abuzoi me pushtetin presidencial kur i kërkoi Ukrainës të hetojë rivalin e tij për zgjedhjet e 2020-ës, Joe Biden, ndërkohë që pezulloi në formë presioni paketën e asistencës ushtarake. Në akuzën e

dytë thuhet se ai pengoi Kongresin duke bllokuar përpjekjet e Dhomës së Përfaqësuesve për t'i hetuar veprimet e tij.

Javën e ardhshme, akuzat do t'i dërgohen për votim në plenare

Dhomës së Përfaqësuesve. Presidenti Trump, i cili këmbëngul se nuk ka bërë asgjë të gabuar, beson se do të ketë një shfaqësim të shpejtë gjatë procesit gjyqësor në Senat, i cili pritet të fillojë muajin e ardhshëm.

Pendarovski: Gjuha maqedonase dhe kombi maqedonas janë fakt



SHKUP, 13 DHJETOR - Qëndrimi i akademikëve bullgarë se nuk ekziston gjuha maqedonase është anakronik për shekullin 20 dhe shekullin 21 në të cilin jetojmë, deklaroi presidenti i Maqedonisë Veriore, Stevo Pendarovski duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve lidhur

me reagimin e Akademisë bullgare të Shkencave (ABSH) ndaj Kartës për gjuhën maqedonase të ASHAM-it. "Gjuha maqedonase dhe kombi maqedonas janë fakt. Gjuha maqedonase është fakt linguistik me dekada dhe dekada prapa dhe jo është vërtetuar

edhe në nivel ndërkombëtar. Mendoj se është e kotë të bisedojmë për diçka që është fakt i gjallë, fakt i njohur që e dinë të gjithë, jo vetëm te ne dhe jo vetëm tek ata, e dinë në tërë botën", deklaroi Pendarovski në margjina të Forumit rajonal të antikorrup-

sionit SELDI në Shkup. Ai potencoi se edhe Marrëveshja e Prespës i referohet Konventës së KB-së të vitit 1979 në të cilën gjuha maqedonase është caktuar si një nga gjuhët në grupin e gjuhëve sllave dhe është e njohur ndërkombëtarisht. (alsat).

ShBA-ja dhe Kina pajtohen për fazën e parë të marrëveshjes tregtare

Uashington, 13 dhjetor - ShBA-ja dhe Kina njoftuan se janë pajtuar për "fazën e parë" të një marrëveshjeje tregtare.

Ujdia do të mundësojë heqjen ose pezullimin e tarifave në vlerë prej miliarda dollarësh.

Aksionet në ShBA shënuan një rekord të ri, me shpresën se do të ketë një zbutje të vazhdueshme të

tensioneve tregtare, midis dy ekonomive më të mëdha në botë. Tarifat e reja amerikane për importet kineze, do të hynin në fuqi nesër (e diel). Por, kjo masë është anuluar tani për tani.

"Ne do t'i fillojmë negociatat për marrëveshjen në fazën e dytë menjëherë, në vend se të presim deri pas zgjedhjeve të vitit 2020", tha presi-

denti amerikan, Donald Trump. "Kjo është një marrëveshje e mahnitshme për të gjithë", shtoi Trumpi. Nëse tarifat e reja do të kishin hyrë në fuqi, atëherë mallrat e prodhuara nga Kina, siç janë: telefonat, rrobat dhe lodrat, do të ishin bërë më të shtrenjta për amerikanët, para festës së Krishtlindjes.

Kjo është një marrëveshje në parim,

që do të thotë se nëse Kina nuk e zbaton ndonjë pjesë të marrëveshjes, administrata amerikane ka mundësinë t'i rizbatojë tarifën. Zyrarët kinezë thanë se "marrëveshja do të sigurojë mbrojtje më të madhe për kompanitë e huaja në Kinë, si dhe kompanitë kineze në ShBA".

Dy ekonomitë më të mëdha në



botë janë përfshirë në një konflikt tregtar për më shumë se një vit, duke goditur njëra-tjetrën me tarifa të mallrave në vlerë qindra miliarda dollarë.

Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (6)

Qëndresa heroike e luftëtarëve çlirimtarë dhe tërheqja në anën e djathtë të Pashtrikut



LULZIM SAHITI

Duke qëndruar si heronj të pamposhtur, pjesa tjetër e ushtarëve të UÇK-së vazhdojnë t'i godasin armiqët me kundërzjarr të fuqishëm. Mirëpo, para syve të ushtarit Bajram Gashi vritet luftëtar i guximtar Fadil Bajrush Rashiti (23) nga Petrova e Shtimes, ndërsa ushtarët e tjerë për ta çelë rrugën e kalimit nëpër luginë hapin zjarr pa mbarim në drejtim nga vinin krismat e armiqve. Kështu arrijnë ta çajnë rrethimin: Rahman Tafa nga Carraleva, Vesel Aruqi-"Rambo" nga Rrezalla, Bajram Gashi nga Pjetërshtica, Aziz Amrushu nga Pjetërshtica, Hazir Murati nga Krojmiri, Ylber Spahija nga Pjetërshtica, Osman Zeqiri nga Varigoci, Selajdin Krasniqi nga Duga, Emrush Behluli nga Carraleva, Daut Kastrati nga Kizhnareka, Enver Deliu nga Rrezalla, Gazmend Nebihu nga Damaneku, Xhevdet Qeriqi-"Rrapi" nga Krojmiri, Isuf Abazi nga Godanci i Epërm, Pajazit Thaqi nga Dabidoli, Bekim Gashi nga Balinca. Haxhi Kiqina nga Bainca e Elshanit, Fehmi Hoti nga Çikatova e Vjetër, Elmi Shala (vëllai i Shaban Shalës) nga Gjurgjica, Avdull Leci nga Gradica, Mehmet Fazliu nga Gradica, Naim Ferizi nga Plluzhina, Sabit Morina nga Balinca, Mujë Ramadani nga

Llapushniku, Xhevdet Topalli nga Bainca, Fetah Kiqina nga Bainca, Avni Lestrani nga Bainca, Haki Morina nga Radosta, Mehmedali Ballazhi nga Hani i Elezit, Xhemshit Krasniqi nga Prizreni, Rexhep Morina nga Gjurgjica, Ramadan Bytyqi nga Gjurgjica, Jashar Shala nga Negrovci, Emin Thaqi, Imer Thaqi, Nasuf Thaqi, Ismet Thaqi nga Llapushniku dhe Esat Halilaj nga Llapçeva e Malishevës. Gjatë tërheqjes, vështirësi në vete ishin edhe të plagosurit, të cilët gjatë gjithë kohës janë ndihmuar nga bashkëluftëtarët e tyre. Xhevdet Qeriqi nga plaga e marrë kishte gjakderdhje të madhe, andaj gjatë tërheqjes është ndihmuar nga Aziz Amrushu, Selajdin Krasniqi, Bajram Gashi, Isuf Abazi e të tjerë. Ka pasur raste kur ushtarët e plagosur kanë kërkuar me ngulmë të vriten nga dora e bashkëluftëtarëve të tyre, vetëm të mos mbeteshin të gjallë në duar të forcave armike. Megjithëse ishte plagosur në herdhë, Pajazit Thaqi gjatë gjithë kohës u mbante moral ushtarëve dhe shquhej për trimëri dhe karakter të fortë luftarak. Gjatë rrugëtimit, i plagosuri Xhevdet Qeriqi, me dorën e djathtë vazhonte ta mbante shtrëngueshëm dorën e plagosur me sa fuqi që kishte pa e lëshuar asnjëherë. Përndryshe ishte rrezik që t'i këputej. Gjaku vazhdimisht i rridhte nga plaga dhe nga acari i madh i ishte ngrirë sikur stalaktit. Ishte borë e madhe me fërfëllizë, mezi arrinin të ecnin. Mali ishte i pakrasitur me degë të thyera të mbetura gjithandej duke rënduar kështu ecjen e tyre. Me t'u ngjitur në majë të Pashtrikut, orientimi i ushtarëve ishte vështirësuar. Kishte rrezik për të humbur rrugën ngaqë atje mbretëronte furtunë e madhe me borë e cila shoqërohej me erë të fuqishme e



Në Stacionarin e UÇK-së nr. 210, në Tiranë, nga e djathta në të majtë: Bajram Gashi, Idriz Hysenaj, Xhevdet Qeriqi i plagosur, Isuf Abazi dhe Emrush Behluli

fërshëllimë. Po të bëje vetëm dy-tre hapa para, kur ktheje kokën mbrapa, gjurmët e këmbëve ishin të mbuluara nga dëborë. Në rrugë e sipër detyrohen të ndezin një ngjyrë të këpucëve për t'u ngrohur sadopak. Duke parë vështirësitë e mëdha të ushtarëve, Xhevdeti kërkon nga bashkëluftëtarët e vet që ta lënë atë e të ecin tutje, mirëpo kur dëgjon këto fjalë, Selajdin Krasniqi nis të vetmuar drejt staneve për të kërkuar ndihmë nga ushtarët e tjerë për tërheqje të të plagosurve. Nga mjegulla e madhe, ai kishte humbur orientimin, ndërsa shokët e tij me shumë peripeci kanë mbërritur te stanet, ku ishte një zjarr për ngrohje, por që për shkaqe të efekteve negative që mund të sjellë ngrohja e shpejtë njerëzve

të ngrirë, nuk janë lejuar të ngrohen meqë ata ishin të mërdhirë dhe ngrohja e trupit të tyre duhej të bëhej gradualisht. Aty u kishte ndihmuar Riza Alia "Hoxha", Atom Avdyl Krasniqi (vëllai i Xhevë Lladrovci) dhe 3-4 ushtarë të tjerë. Prej staneve, ushtarët kanë mbërritur në mbrëmje në Vlahën. Mandej janë transferuar për mjekim intensiv në Krumë, Kukës dhe në Stacionarin e UÇK-së nr. 210 në Tiranë, që udhëhiqej nga dr. Shaip Muja. I fundit ka ardhur në Vlahën, Selajdin Krasniqi, i cili kishte humbur rrugën në majë të Pashtrikut.

Përgjegjësi i ushtarëve të Nerodimës dhe Batalonit "Ruzhdi Salihu", Afrim Musliu, së bashku me luftëtarët e vet rezistojnë trimërisht, ku në këtë betejë të ashpër kanë rënë dëshmorë: Hafir Imri Bajrami (18) nga Zborci, Isa Xhemshir Olluri (19) nga Krojmiri, Naser Shefki Kelmendi (22) nga Karaqica, Qamil Hysen Olluri (22) nga Krojmiri, Ramadan Deli Elshani (29) nga Shtimja, Mentor Ramadan Ibriqi (19) nga Komarani, Arben Rexhep Hyseni (18) nga Godanci i Epërm, Xheladin Hamdi Xheladini (22) nga Carraleva e Kadri Haki Ademaj (23) nga Petrova. Trupat e këtyre dëshmorëve u bënë mburojë e çeliktë për ta mundësuar tërheqjen e shokëve të tyre. Forcat serbe bërtitnin me zë të lartë në gjuhën shqipe dhe serbe "Predajte se, opkoljeni ste!" (Dorëzohuni, jeni të rrethuar!). Dhe këta trima të pamposhtur, britmave të tilla iu përgjigjen vetëm me plumba. Madje, duke dëgjuar ftesën serbe për dorëzim nga zemërimi i madh, ushtari trim e sypatrembur, Hysni Shaip Kajtazi (19) nga fshati Tërni i

Ferizajt, për një çast ngritët në këmbë si vigan, që nuk kursej asgjë për lirinë e Kosovës, duke gjuajtur në drejtim të forcave armike me sa fuqi që kishte deri në rënien e tij heroike, ashtu siç bien trimat e vërtetë. Kjo betejë ishte humbje e madhe për UÇK-në, mirëpo u bë motiv për shumë djem dhe vajza të reja, që të vazhdohet rruga drejt lirisë dhe çlirim të vendit.

Ndërkohë një cifël e bombës e godet në kokë luftëtarin e ditëve të para të UÇK-së, Bashkim Beqajn, të cilin e përshkon gjaku fytyrës. Ky më nuk mund të fliste, por vetëm me lëvizje të duarve kishte kërkuar nga Beqir Luma një xhakete. I dridhej tërë trupi nga ethet. Pak më lart, ciflat e bombës e kapin në këmbën e djathtë edhe luftëtarin tjetër, Sadri Krasniqi, të cilin fuqia e bombës e rrotullon në vend. Më vonë ka vërejtur se në të njëjtën kohë e kishte goditur në këmbën e majtë edhe një cifël e predhës. Sadriu tërhiqet teposhtë luginës, ku takon Bashkimin, të cilit ende i rridhte gjaku fytyrës. Meqë goja i ishte marrë, Bashkimi përmes gjesteve kishte kërkuar nga Sadriu dhe ushtarë të tjerë që ta vrasin me revolen e tij, të cilën e barte në brez e mos ta lënë në duar të armikut. Pranë tyre një plagë përmbi gju e kishte marrë edhe Avni Shiti, në këmbën e djathtë.

Pak pa aguar mëngjesi, forcave armike u vjen në ndihmë edhe një helikopter ushtarak, mirëpo ndodhi fati në fatkeqësi, kishte rënë një mjegull e dendur nga e cila një pjesë e ushtarëve të UÇK-së tashmë kishte arritur të tërhiqen dhe shpëtojnë nga ky rrethim i hekurt. Pra, deri në mëngjes kishin vazhduar luftimet për jetë a vdekje. (Vijon)



Vlahën, nëntor 1998, luftëtarë të Batalionit të Dytë "Ruzhdi Salihu", të Brigadës 121 "Ismet Jashari - Kumanova", nga e majta në të djathtë, ulur: Emrush Behluli, Hafir Bajrami, Aziz Amrushu, Ramadan Elshani, Bajram Gashi, Xheladin Xheladini, Ylber Spahija dhe Naser Kelmendi, ndërkaq në këmbë janë: Xhevdet Qeriqi, Xhavit Krasniqi, Astrit Bytyqi, Rahman Tafa, Bashkim Krasniqi, Isa Olluri, Bekim Gashi, Selajdin Krasniqi dhe Sadri Krasniqi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



DASHURIA PËR VATËR DHE ATDHE NUK SHUHET KURRË



SHKRIMTARI, Z. BEHRAM HOTI

Të shkruash për mikun tim të penës dhe të pushkës, shkrimtarin, z. Behram Hoti nuk është aspak e lehtë, sepse nuk ka çmim që e paguan punën e tij të madhe krijuese, në rrafshin e unitetit kombëtar, gjatë procesit të pajtimit kombëtar, në kohërat më të vështira për popullin dhe kombin tonë. Por për lexuesit e respektuar do të mjaftonin fjalët që shpesh më thoshte dhe i potenconte i ndjeri, Prof. Anton Çetta, gjatë takimeve që i kisha më të, ku thoshte: "Një dorë e njerzëve jetojnë me heshtje e tyre. Ata në heshtje veprojnë, e krijojnë. Për njerëzit që në heshtje veprojnë dhe krijojnë historia nuk heshtë kurrë, shkruan më vonë". Për mikun tim të penës dhe të pushkës, po t'i shkruaj edhe qindra faqe të librit, nuk do të mjaftonin, por nuk po e zgjas më tepër në këtë libër publicistik-letrar, i bindur plotësisht se me ndihmën e Zotit do të vazhdoj të shkruaj edhe në të ardhmën për mikun tim të penës, i cili në atë periudhë të rëndë kohore për popullin tonë, i mbante edhe: "SHËNIMET PËR LËVIZJEN-LKPGJ", duke i evidentuar të gjitha takimet e profesorit që i mbante gjatë pajtimit anekënd trojeve shqiptare, një pjesë të të cilave do t'i publikojmë shpejt në librin e radhës me një dokumentar, për pajtimet e gjagjeve, "Anton Çetta, Orakull i Pajtimit Kombëtar", Prishtinë 1995 Kjo ishte libra e parë, për lëvizjen 1990-1992, por Behram Hoti që nga ajo kohë e deri sot, zhvilloi shumë intervista, e bëri shumë reportazhe nga frontet e luftës gjatë viteve 1990-1999, të cilat ishin në frymën kombëtare. Në këtë libër është paraqitur vetëm një pjesë e shkurtër e punës së profesorit z. Behram Hoti. Mbetet edhe shumë për t'u shkruar e për t'u thënë...

Fadil Curri, shkrimtar

ISBN

BEHRAM HOTI



DASHURIA PËR VATËR DHE ATDHE NUK SHUHET KURRË



PRISHTINË, 2019

DASHURIA PËR VATËR DHE ATDHE NUK SHUHET KURRË

BEHRAM HOTI

Recensioni për librin "Dashuria për vatër e për atdhe nuk shuhet kurrë" të autorit Behram Hoti

Përrurohet libri i autorit Behram Hoti 'Dashuria për vatër e për atdhe nuk shuhet kurrë'

Shkruan: Zymer MEHANI

Më 12 dhjetor 2019 në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" u përrua libri publicistik "Dashuria për vatër e për atdhe nuk shuhet kurrë" i publicistit dhe veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, z. Behram Hoti, i njohur edhe si Mal Drenica, koordinator i Lëvizjes Pajtimi i Gjaqeve (1990-1997), luftëtar i të tri luftërave tona të fundit çlirimtare si dhe delegat i Kongresit të Parë të Republikës së Çamërisë (Sarandë, 2018).

Libri përmban intervista, reportazhe, kronika, rrëfime historike nga e kaluara e lavdishme e popullit tonë, që nga periudha e të madhit Shaban Polluzha, e pajtimtarit të gjaqeve në Kosovë, shpirtndriturit Anton Çetta, për të ardhur te epoka lavdiplote e komandantit Legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës, i pavdekshmi Adem Jashari!

Pos fjalëve përshëndetëse, vlerësimeve nga redaktori dhe recensentët, pikave të shkëlqyera muzikore ekzekutuar nga rapsodi i njohur nga Shkupi, Tahir Seferi e fjalës falënderuese të autorit, Behram Hoti, u ndanë edhe mirënjohje.

Libri "Dashuria për vatër e për atdhe nuk shuhet kurrë" i autorit, prof. Behram Hoti është libër publicistik. Ku e gjeti burimin profesori i nderuar, z. Behram Hoti për ta hartuar një libër të tillë? Është pyetja që secili prej nesh, sapo të hasim në faqet e këtij libri, mund t'ia bëjmë vetes, dhe përgjigja s' do mend se është tejet e qartë. Burim frymëzimi për çdo shkrim, qoftë ai letrar, historik a publicistik, i autorit Behram Hoti është ambienti shqiptar, shpirti i kombit i cilitur e i drobitur, i trazuar e i lënduar, i ndarë e i vrarë shpeshherë

gjatë historisë; shpirt ky, kryengritës për liri përgjatë shekujsh, por kurrë i nënshtruar as i mundur nga tufane e rrebeshe armiqsh të pamëshirshëm. Burim frymëzimi i autorit Hoti është pra trualli amtar, gjithëshqiptar gjithandej kah shtrihet Shqipëria Natyrale: Kosovë, Iliridë. Luginë e Preshevës, Hot, Grudë, Plavë e Guci dhe Çamëri.

Libri publicistik "Dashuria për vatër e për atdhe nuk shuhet kurrë" i publicistit z. Behram Hoti në strukturë të vet përmban intervista, reportazhe, kronika, rrëfime historike nga e kaluara e lavdishme e popullit tonë, që nga Epoka e atdhetarit Shaban Palluzha me shokë (1944-45) e te Epoka e Plakut Leshbardhë-Pajtimtarit të Gjaqeve në Kosovë, prof. Anton Çetta (1990), për të ardhur tek epoka ademjashariene dhe e Ushtrisë së lavdishme Çlirimtare të Kosovës (1997).

Pena e artë e publicistit Behram Hoti, pra na ka dhuruar një libër margaritar, në të cilin kronologjikisht do të gjejmë dromca vuajtjeje, dhembjeje, por edhe heroizmi e krenarie, duke trajtuar tema të ndryshme, si arsimit dhe edukimi i brezave, vështirësitë dhe sakrificat e një armate të tërë nxënësish e mësimsdhënësish për arsimim të mirëfilltë shqip, që për asnjë çast, në asnjë rrethanë nuk e fikën flakadanin e dijes...

Libri i publicistit Behram Hoti është konceptuar në katër kapituj, të cilët pastaj e përbëjnë tërësinë. Kapitulli i parë: Arsimit dhe edukimi do t'i prijë librit, sepse për profesorin e nderuar z. Behram Hoti arsimit dhe edukimi përbëjnë shpirtin e kombit. Këtu me korrektesë dhe me fakte të pakontestueshme z. Hoti ka ravijëzuar figurat emblematiche të intelektualëve të denjë të Cecelisë së Vushtrisë. Është fjala për profe-

sorët Latif Mulaku e Rexhep Vraniqi, të cilët shkrinë gjithçka patën për ndriçimin e mendjeve të brezave të tërë me arsim e dije në gjuhën shqipe.


Në këtë kapitull, prof. Hoti, veç tjerash do të flasë edhe për Shkollën e Likocit të Skënderajt, vatër dhe arsimit dhe e lëvizjes kombëtare, ku u edukuan dhe u kalitën shumë zemra atdhetare, që më pastaj u vunë në shërbim të atdheut. Më tutje, z. Hoti shkruan edhe për Shkollën "Afrim Shala" të Korroticës së Poshtme, duke na e dhënë një letërnjoftim të këtij mesidrenicas dhe duke përmendur shumë emra mësimsdhënësish veteranë, që me përkushtim edukuan breza të tërë.

Portreti i ravijëzuar me vullnet dhe me admirim nga pena e publicistit Behram Hoti është edhe figura e Sulejman Drinit, veteran dhe pishtar i arsimit dhe i kulturës sonë mbarëkombëtare.

Kapitullin e dytë: Vuajtjet dhe tragjeditë e popullit tonë ndër shekuj, autori Hoti e nis me një kronikë historike në Likoc të Skenderajt, kushtuar nënës Sofije, të cilën, siç thotë autori, brezi i burrave të Shaban Palluzhës e quante Nëna e Kombit. Dhe vërtet ajo ishte Nëna e Kombit, ngase kur familje të tëra të fshatrave të Drenicës dhunoheshin sistematikisht nga çetnikët serbë, kjo nënë ua hapi dyert e shtëpisë karvanit me fëmijë dhe gra, me dashamirësi dhe bujari të paparë, duke ua ndërruar rrobat dhe duke i shpërndarë për t'u çlodhur nëpër çilarët (dhomat e nuseve), pastaj në shtëpi të zjarrit (te vatra), në plevicë e gjetkë nëpër plangun e saj.

Pena e artë e prof. Behram Hoti do të na e sjellë të ravijëzuar si është më së miri edhe portretin e dëshmorit të kombit, Isa Kastrati nga Hogoshti i Anamoravës, karakterin atdhetar e luftarak të tij, gjaku i të cilit u ngjit në flamur të shqipja dykrenore. Autori Hoti na ka sjellë të dhëna biografike të bollshme të dëshmorit Isa Kastrati, për veprimtarinë e tij patriotike dhe për humanizmin që ai tregoi ndaj familjeve të Drenicës, kur plasi lufta në Likoshan, e në fund, me dhembje, por krenar prof. Hoti e përshkruan edhe rënien e trimit, më 21 prill 1999, më malet e Marevcit, kur ishte duke deportuar shokët luftëtarë: Sokol Sopin e Afrim Vitinë për në Spitalin Ushtarak të UÇK-së në Llapashticë të Llapit.

Autori Behram Hoti do të shkruajë edhe për kasaphanën në Kullën e Talit në Drenas të Drenicës, që u bë gjatë dhjetorit 1944 dhe në janar 1945, ku u vranë e u masakruan 172 burra shqiptarë nga Drenica, Llapi e nga vise tjera të Kosovës, për të vazhduar më pastaj me shpalimet e krimeve partizano-çetnike mbi shqiptarët, ashtu siç ndodhi edhe në Kafenenë e Sllavojkos, ku u ushtroa kasaphanë e paparë në dhjetor 1944 dhe janar 1945, me ç'rast u sakatosën mbi 500 shqiptarë nga



Drenica, Istogu e Llapusha. Viktimat ishin masakruar te Çarri i Madh e kufomat ishin hudhur në lumin Klina e në puse. Këtë masakër e pat ndërprerë Brigada e Shaban Palluzhës.

Autori Behram Hoti vazhdon të rrëfejë edhe për bëmat kobzeza të partizanëve, të cilët, veç tjerash, shqiptarët i prenin dhe i çanin me sopata. Ky kapitull përmban edhe kronika e reportazhe mjaft interesante.

Kapitulli i tretë: Për dëshmorët e kombit përshkohet nga fryma e Epokës Ademjashariene dhe përpjekjet e pareshtuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në luftën çlirimtare. Autori Hoti do t'i ravijëzojë portretet e dëshmorëve, të të burgosurve politikë, dhe të të plagosurve shqiptarë, siç janë Adem Mulaj, epror i UÇK-së; Agim Prokshi ish i burgosur politik; Hasan Jashar-Hoti nga Likoci i

Drenicës, hoxhë Idriz Kosova, urtar dhe pajtimtar i gjaqeve. Pra, s'do mend se kjo kaptinë përshkohet nga figura dëshmorësh, të burgosurish politikë e klerikësh atdhetarë. Autori Hoti do të shkruajë për Pajtimin e Gjaqeve (1990), për Djaloshin e Demonstratave, Shefqet Adem Muslia, për të zhvendosurit nga vatrë e luftës në Drenicë; për viktimat në Burgun e Dubravës; për Pranverën Kryengritëse Shqiptare të vitit 1981; për moralin ushtarak e kombëtar të UÇK-së; për Gjeneralin e gjeneralëve shqiptarë, Shaban Palluzha etj. Po ashtu, autori Hoti në këtë pjesë na ka sjellë edhe vështrimin e tij për librin monografik "Vesël Haxha-Galica" të autorit prof. Bedri Tahiri e shumë shkrime të tjera. Libri përmbillet me një kaptinë të veçantë, në të cilën do të gjejmë shkrimet e të tjerëve për profesorin, publicistin, humanistin,



poetin e shkrimtarin z Behram Hoti. Më i angazhuari me shkrimet e veta për prof. Hoti është prof. Nexhat Mustafë Ballanca-Dibra, i cili shkruan për veprimtarinë letrare të Behram Hotit nga koha e luftës dhe e pasluftës, për shkrimet e Hotit pas Pavarësisë së Kosovës etj. Po ky autor do të shkruajë në vazhdimë me rastin e 55-vjetorit të veprimtarisë atdhetare të poetit, prozatorit, romancierit e publicistit Behram Hoti në gazetën "Epoka e re".

Krejt në fund. Tashmë të gjithë e dinë se kudo në botën shqiptare, por edhe në diasporë, emri dhe pena e prof. Behram Hoti është e njohur, ngase ai prore ishte dhe është në kontakt me lexuesit e tij të shumtë përmes gazetave e revistave shqiptare, duke u sjellur atyre xhevahire të mrekullueshme letrare, historike e publicistike me taban kombëtar.

Le t'i përmendim vetëm disa prej gazetave e revistave, ku pena e prof. Behram Hoti la dhe po lë gjurmë; "Rilindja", "Bujku", "Bashkimi", "Zëri", "Fakti", "Flaka", "Nacional", "Shkëndija", "Dituria Islame", "Epoka e re", "Kosova Sot", revista "Kosovarja" etj.

E themi me admirim se prof. Behram Hoti si me laps, por edhe me pushkë dhe me aktivitete të pareshtura ishte dhe është përherë në shërbim të atdheut dhe të kombit. Prandaj ky burrë drenicas i takon mbarë kombit shqiptar, që me krenari e mban emrin profesor Behram Hoti-Mal Drenica i Pamposhtur. Ky uragan i pandërprerë gjatë periudhës 1990-1997, iu përgjigj kushtrimit të atdheut duke u rreshtuar në radhët e Tri ushtrive Çlirimtare (UÇK, UÇPMB, UÇK) dhe së fundi duke u zgjedhur delegat i Kongresit të Parë të Republikës së Çamërisë.





Intervitë me Violeta Murati

Ledia Dushi: Gegnishtja nuk është 'kalë beteje', është damar në një trup poetik

Po kalojmë një tronditje të madhe, pothuaj ashtu siç ju shpreheni po përjetojmë një gjamë. Si mundet njeriu të bëhet i fortë, të jetë një qenie superiore, të krijojë vetëbesim...

Poezinë tuaj, 'n`nji fije t`thellë gjaku' e ndan me këto momente... Vdekja është asgjë, ose është gjithçka. Të meditolesh mbi vdekjen në një qetësi të kërkuar, si kusht thelbësor për filozofitë, budizmin apo krijuesin nuk është e njëjta gjë si me u perball me vdekjen. Për krijuesin vdekja nuk është fundi, por për të mbeturit në kurthin e një fatkeqësie të pa thirrur, e tillë është thujse gjithnjë fatkeqësia, vdekja është fund. Në këndvështrimin poetik e filozofik njeriu, sendet vdesin vazhdimisht. Ndryshe nuk do të ekzistonte koncepti i ndryshimit. Vdekja si prishje e kufirit poetik,

vdekja si fatkeqësi, shkatërrim, vdekja si objekt studimi...mundesh me e pa simbas interesit në pafundësi vështrimesh... E vdekja si ndërprerje egër e jetës, dhimbja e gjama e humbjes kolektive e udhëheq njeriun në një grishje shkatërruese, e bën me u ndje i pa aftë, bosh, i kotë...vdekja e ka këtë efekt... Çdo fjalë është e kotë, ngushëllimi i humbjes nuk vlen, çkado që të thuash është e pavlerë për veshin e të dëmtuarit. Në fund të llogarive, mbërthyer prej dhimbjes e vetmja pasqyrë që të mbetet është qielli. Njeriu i cili është aq kerkues dhe mohues në

të njëjtën kohë, me t`u ndodhur përpara të keqes i duhet me u përballë, e qysh në zafilljen e kohëve i është drejtuar qiellit, të paarrishmes, burimit të së pashterrshmes, mitit, shpirtit, frymës, Zotit... Është po vetë njeriu ai që ka ditë me vepru nëpërmjet ritit e performancës e me përcjellë të vdekurin për kah amshimi, duke e tejkaluar vdekjen, humbjen, dhimbjen, e në të njëjtën kohë ka pranuar konceptin e kalimit në një tjetër `jetë`. Njeriu vetë është thyer në gjunj nga shkatërrimi e vdekja e po vetë është çuar me kalu përtej saj. "n`nji fije t`thellë gjaku", poezinë time e ndaj, e ofroj në këto momente, si mundësi kalimi, transportimi nga realiteti, nga e përditshmja, si një nxitje për besim; edhe pse njeriu është i vdekshëm, Shpirti është i pakohë.

Nuk është koha për të folur për

poezinë, letërsinë me çfarë po përjetojmë por ka një fuqi mbinaturore të shkruarit, të asaj që quhet gjendje e brendshme, a metafizikë që rroket në pavetëdije realiteti ...ju si keni nisur ta shprehni këtë, të mendoni poetikisht? Diku kam lexuar një thënie që më ka bërë përshtypje e që në një farë mënyre më shpjegon, Poezia është poezi e madhe nëse ka frymëmarrje filozofike, përndryshe është një pikëz loti e së përditshmes... Të menduarit poetikisht, siç e quani ju, është patjetër frut i dhuntive personale por edhe i një fenomenologjie të mishëruar e të gjallë. Kush e përcjell nga vetja Poezinë e njeh së brendshmi dashninë e të menduarit poetikisht, në atë masë sa të jetë i aftë të nxjerrë nga objektet apo detajet e zakonshme një jetë sekrete, e cila përmjet poezisë destinohet për diçka tjetërpërtej përdorimit të zakonshëm. Bëhet fjalë për një rend të ri të sendeve, i

cili për fat të keq a të mirë nuk mësohet, por ekziston ose jo. Të bëhet se je magneti i gjithçkaje që të rrethon, që shihet apo ndihet e ndërsa përplasat te vetja për arsye të providencës mbase, shënohet në një çast të vetëm në letër, për ta risjellë `botën` gjithnjë në një tjetër mënyrë. Të pamit e botës është personal, e kjo ndodh prej gjithnjë, përfshirë këtu shtrirjen kozmike e atë personale. Për personin nis, ose ma saktë rimerret qysh nga fëminija. Hannah Arendt ka një shkrim ku e merr peshkatarin e perlave si figura e një farë mënyre të menduari. E quan të mendurit poetikisht. Arendti i referohet Ëalter Benjamin Burri i perlave. Kush e ka për zemër teknikën e `çmontimit` dhe do të provojë rrugë të reja të mendimit, le të bëjë si peshkatarin i perlave në fund të detit, të marrë gjërat më të çmueshme, "koralet", "perlat" të

cilat "ende mund të shpëtohen por vetëm si fragmente".

Ishte fillim '90-ta, e ju veçse një 15 vjeçare kur emri juaj, apo më mirë zëri poetik ktheu, jo padyshim, vëmendjen... shkruani gegnisht qysh në fillim, madje herët fare, duke qenë nga shkaqet e një polemike të hapur mbi shkrimin në gegnisht. Sigurisht keni thyer tabu. Çfarë kujtoni, ç'gjurmë keni marrë me vete deri sot?

Secili poet është ai mbledhësi i perlave e koraleve që "peshkon" fragmentet e i bashkangjitet së tanës. Në të vërtetë nuk është "gjuha" qëllimi. Madje nuk ekziston asnjë qëllim i jashtëm e objektiv. Ti gjelesh në segmentin që kujton se është i yti, por në të vërtetë nuk është tjetër veçse një hallkë e thjeshtë e së tanës dhe kjo gjë nuk ta lejon pamjen e plotë dhe nuk të lë mundësi me u ndeshë me qëllimshmërinë. Poezia e njëmendtë qëllon ma së nalti, jo për shkak të gjuhës, por për shkak të thelbit mistik dhe vertikaltetit. Për njerëzimin është më i thjeshtë një Krisht në Kryq i dukshëm e i prekshtëm, sesa pepjekja me iu qasë Krishtit si Gnosë.

Një qasje tjetër, ndryshe në raport me poezinë e para viteve 90-të, ky ishte në të vërtetë "problemi"; të menduarit dhe të ndjerit ishte më në fund mbrenda "hapësirës" ku isha rritë, në të gjitha kuptimet. "Gegnishtja" nuk është "kalë betejë", është damar furnizues në një trup poetik.

Ka një kohë për ju, një kohë që nxit shkrimin, çfarë relacioni krijon tek ju?

Akti i krijimit, më saktë procesi i ngjizjes nuk ka dëshmitarë. Nuk ka dëshmitarë e as dëshifruer. Qenia, bartësi është fragmentar, shtrirja është e përjetshme. "Koha" në këtë kuptim nuk është aspak relevante; "nxitja" është vertikale e nuk merr në konsideratë asgjë që shtrihet e përçon "poshtë" saj. Me gjithë vitet, të cilat mund të jenë të rëndësishme për njeriun por jo për Shpirtin, Poezia nuk është diçka që e zotnoj, përkundrazi më zotnon e zotnimi thjesht ndodh, nuk ka raport e as shpjegim.

Preferoj ta përsëris edhe një herë faktin, pas promovimit të librit tuaj në Panairin e librit 2019, se para dhjetë vitesh ju nxorët vëllimin me poezi, në një rreth miqsh të ngushtë, ndërsa shfaqja e kësaj antologjie poetike merr një përmasë tjetër duke ardhur në një ngjarje të tillë të librit. Ka diferencë sipas jush, pse ky viciozitet shoqëron poetët? Si erdhi nxitja për këtë libër?

Mendoj se është pikërisht ky rasti të shpreh mirënjohjen për botuesin zotni Bujar Hudhri i cili më dha mundësinë e botimit të përmbledhjes time poetike dhe të shpërfaqjes së saj. Mirënjohje edhe për ju Violetë, si nxitëse e botimit të "n'nji fije t' thellë gjaku" si dhe për nxitjen e vazhdueshme që i keni bërë lexuesit shqiptar duke i sjellë dhe risjellë përmjet shtypit të përditshëm poezinë dhe

letërsinë e autorëve të pas viteve '90-të.

Vazhdoj të jem e mendimit se poeti është "genie antike". I paafte për zhurmën dhe turmën. Poeti është odë e mbyllur. Poeti vetë nuk është medium më i mirë për të bërë lidhjen e poezisë së vet, nga ana tjetër, poezia nuk komunikon lehtësisht me këdo që kalon aty-pari, kështu që ai që ju e quani "viciozitet" është gjendje e zakonshme e poetit.

N'nji fije t' thellë gjaku? Pse nëpër të?

Shqetësimi ma i madh mbetet aty ku zanë fill sendet, ku zë fill gjithçkafja. Kërkimi poetik, për mua, zë fill vertikalisht dhe në thellësi. Thellësia është shtrirje, shtrirje e tejkohshme, konceptuale. Ideja e gjakut si një fije, si litar që hidhet për t'u mbajtur, si fillim, si krijim përbën edhe thelbin që e mban poezinë. Gjakut është gjenetikë fizike e shpirtnore. Kemi një "fije të kuqe" në Bibël e cila fillon në të vërtetë me Adamin e përfundon me Jezu Krishtin.

"Poezia e Ledia Dushit nuk vjen në shqip nga diku e dikur, sepse është kudo e kurdo për lexuesin e përkushtuar. Ajo fton heshturazi vetëm ata që janë në gjendje ta përjetojnë, ose ata që ëndërrojnë dëshpërimisht rritjen shpirtërore përmes poezisë"... Na tërheq kjo parathënie e Ardian Kycyikut, duke menduar se ka një tërheqje prej jush, pse vjen ky identifikim, kemi jo pak raste të 'heshtjes', mënjanimit në letërsi.

E ceka edhe më lart, poezia është më afër heshtjes se zhurmës. Si mënyrë e hershme e të shprehurit, si enë e veçantë e mbledhjes së të çmuarës shpirtnore, ngjan aq pak me detin ku futen të gjithë, i cili është gjithashtu i mrekullueshëm, port të kujton fort një objekt të antikitetit, lotoren, e cila përdoret për të mbledhur lotët në rast vdekjeje...

Duhet ta pranoj që është shumë e vështirë të thuash diçka të vlefshme e të kthjellët, mbasi ke lexuar esenë e Profesor Kycyikut e cila e paraprin shpërfaqjen e poezisë sime në përmbledhjen e paraqitur në Panairin e Librit të këtij viti. Dëshiroj t'i shpreh mirënjohjen time më të thellë Ardian Kycyikut i cili pati kohën e mirësinë me e lexue e me e lexue pikërisht në këtë mënyrë poezinë time.

Ju përmendët më lart letërsinë e pas viteve '90-të...

Nëse ka një periudhë mbas së cilës jam pafundësisht e lidhur, nga e cila sido që të shkojë, nuk mund të shkëputem, e vetmja kohë reale së cilës i përkas, është periudha e ashtuquajtur e pas viteve '90-të. Kjo periudhë është, n' mendimin tim edhe më e rëndësishmja në letërsinë e re shqipe. Periudha kur shpërfaqen e zhvillohen i bashkon shkrimtarët e poetët e kësaj periudhe, përndryshe secili thërret në zanin e vet. Për poezinë nuk është kurrë koha, e megjithatë poezia e grupimit në fjalë mbetet e papërsëritshme. Kam qenë më e

reja e të gjithëve që ende vazhdon të shkruarit; i kam lexuar të gjithë. Edhe kur flisnin, më shumë i kam dëgjuar; për shumicën prej tyre edhe kam shkruar, si një ftesë për lexim e rilexim, sërish një sfidë ndaj kohës. Pavarësisht fatit njerëzor të secilit prej tyre, zani i secilit është i padiskutueshëm.

-Femna s'asht Njeri- thoni. E çfarë është?

Më vjen më së pari ndërmend koncepti i Eternal Feminine, "das Ewig-Weibliche" i Goethes, i cila shfaqet në letërsi më 1832 me publikimin e pjesës së dytë të Faustit. Bëhet fjalë për një histori të lashtë arketipale qysh nga periudha pre-patriarkale deri në epokën moderne. Eternal Feminine është gjithashtu një arketip Jungian një "imazh primordial", që zërthehet në pesë figura historike: Perëndesha e Madhe e prehistorisë, Sophia Gnostike, Maria e kultit mesjetar, fenomeni i Madonës së Zezë dhe Sophia mistike.

Femna asht tanësi, asht entitet... Femna mundet me të zbrazë, femna mundet me të përmbush pa masë e pajada. Femna mundet me t' i ba sytë të ujshëm, si sytë e Shivës që ujohej prej hashishit. Mohimi në rastin tim, në poezinë që ju citoni nuk nënkupton mangësi, por heq ironikisht thelbin, kushtin e ekzistencës për me e mbushë e plotësue mandej me një pafundësi elementesh të cilët sado e sido nuk e përmbushin të tanën, në synin tim.

Po ndaj këto vargje:

Liria ime
frymon n'mal:
ma e vjetra
ndër bimë
helmuese.

Në të tjera vargje thoni:

Liria
asht e gjelburn,
e sytë e mij
binjakë...

Pas këtyre vargjeve, cila është Liria juaj?

Ma së pari ju falemnderës që përmendni vargje të mija të hershme, e kjo kallëzon që koha nuk ekziston... Liria për mua asht një kufi i pambërrimë, sepse njeriut i asht dhanë jetë e matshme në vite, cka nuk mjafton krahasue me djegën, dëshirën e njeriut për dije...

Liria për mua është Dija, dija të bën të lirë. Njeriu duhet të digjet për të ditur, kështu edhe bën të zhduket kohën.

Çfarë fuqie është hyjnia, e shenja tek një poete, krijuese?

Lidhur me këtë më vjen ndërmend Stefan Cvajgu në, Lufta me demonët: Holderlin, Kleist, Nietzsche, në të cilin njëri nga tre esetë ia kushton lirikut gjerman Holderlin, dhe thotë: "Asnjë poet gjerman nuk ka besuar ashtu siç Holderlini besonte te poezia, te origjina e saj hyjnore, askush nuk e ka mbrojtur me aq fanatizëm mungesën e kushtëzimit dhe të infektimit nga gjithçka tokësore". Poezia, vazhdon Cvajgu, është kuptimi i jetës. Ajo mbush humnerën që ekziston mes mbi dhe nën shpirtit, mes perëndive dhe njeriut.

"Do të doja të jetoja për artin të cilit i përket zemra ime, por ndërkohë më duhet të bjerrem mes njerëzve, aq sa shpesh ndjehem tejet i lodhur nga të jetuarit..."

Kështu shpreh në një letër Holderlin, liriku më i madh gjerman, mbas Goethes. Në gjykimin tim, Poeti i njëmendtë, ashtu si

Holderlini, nuk e përdor "poetikën" e tij për të arritur një farë autonomie estetike romantike, por përkundrazi i jep kësaj "poetike" dimensionin religjioz, duke e shndërruar këtë gjë në vetë misionin e tij. Në gjykimin tim, ky përbën vetë kushtin thelbësor të të qenurit krijues.

A të mjafton vetëm poezia, e vetmja shprehje e juaja deri sot?

Nuk e di nëse poezia është pak apo shumë, e mjaftueshme ose jo; përmasa e poezisë nuk më ka shqetësuar ndonjëherë. Ajo çka kam, ajo që më ngarkon, që më përfshin, ajo çka më drejton kah vetmia me qëllim kjarhtësinë, është poezia. Çka më grish nuk është fjala në vetvete, por ndjesitë, tingujt, ngjyrat, kërkimi i brendshëm të cilët nuk e kanë thirrë poezinë si mënyrë të shprehur, por e kanë risjellë atë.

"fmij kam mujt me ngranë shega e shega e hurma / e mos me u ngopë tash ajri s'm'ngopë as zemra që mbaj / as sytë s'm'ngopin aq duen me pasë / gjak s'di sa kam as jetë as frikë as dashni / as njerëz me humb as mend me nxjerrë"...çfarë mbetet pa sos në jetë, tek ju?

Dëshira për me e lexu Shpirtin nëpërmjet udhëtimit në toka të hershme e tempuj ku shihet e kjarët zanafilla, ku ndihen të avullt Zotat e ku asgjë nuk merr fund... kjo si pjesë e asaj çka askush e asgjë nuk mundet me e sosë, Dija.

-Diellin kam me e pa n' bërthamë t' dashnisë... Kur përpjekjet, kërkimet bëhen me zbërthi dashninë, ç'berthame është, ju e vendosni pothuaj si shkak, si në kontrastet e mësipërme, ne forcë energjie, jo përmase, dimension. Sa nxë, sa djeg, sa mban dashunia- siç ju e shkruani?

Poeti e jeton poetikisht botën, e mbush me sendte të dritshme, e mbush me frymë, me energji. Dashnia është më e madhe se sendet, madje Poeti, Dantja, thotë se lëviz edhe diellin, si

shprehje e motivit të vet ideal që e nxit vazhdimisht drejt qëllimit të tij. Dashnia e ndan të tanën veç me Vdekjen. Prandaj i jep jetë gjithçkaje, mban gjithçka, përdrit pa fund dhe mban deri në amshim, duke u asgjësuar dhe ngadhënjyer mbi veten.

Si e mendon lexuesin tënd?

Krijimi në zanafillë nuk e njeh lexuesin. Ajo timtë kohe që e konsumon eterin në fjalë, nuk e përfill kohën e as matësit e saj. Megjithatë pyetja vjen në t' frohtë, pra larg procesit të krijimit e kështu po përfitoj me thanë se lexuesi në rastin ideal kishte me qenë dikush modest, i pashqetësuar për kuptimin e sendeve, por i thirrur, i grishun prej poezisë për arsye që nuk i din e as nuk i interesojnë, po aq sa i grishun aq edhe i identifikuem mbrenda ndjesive të tekstit për arsye që prapë nuk e vlejnjë asnjë shpjegim e logjikë.

**Portreti nga Ina Lajthia.
/exlibris.al*



E rrallë

Ushtria turke, dron me mitraloz të rëndë

Turqia do të jetë vendi i parë që do të blejë një dron të ri ushtarak të armatosur me mitraloz dhe të pajisur me krahë robotikë që shërbejnë për ta zbutur zbrapsjen nga të shtënat e plumbave. Mitralozi ka aftësinë të lëshojë 15 plumba në një breshëri të vetme dhe droni mban në total 200 fishekë. Droni është zhvilluar nga Asisguard, një kompani teknologjike në Ankara, e specializuar për teknologji ushtarake.



FOTO E DITES



Të premten Shqipëria ka përcjellë kontingjentin e VI të forcave të veta në grupbatalionin e NATO-s në Letoni.

E jashtëzakonshme

Zbulohet pika më e thellë në tokë

Pika më e thellë në tokë është zbuluar në Antarktidën lindore, në masivin akullnajor të Denman. Kanioni arrin në 3.5 kilometra thellësi, poshtë nivelit të detit, ndërkohë që vetëm kanionet brenda oqeanit shkojnë më thellë. Zbulimi i kësaj forme të tokës do t'i ndihmojë shkencëtarët për t'i kuptuar ndryshimet në polin e jugut. Gjetja



e re tregon se kreshtat e panjohura më parë do t'i pengojnë akullnajat të shkrijnë në një botë që po përballet me ngrohjen globale.

BARSOLETA E DITËS



- Pse zihen në mes vete dy bionde mbi një motor?
- Shtyhen për ta zënë vendin kah dritarja.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Një fillim dite i mbarë dhe sot


prireni ta ndihmoni këdo që ka nevojë për ju. Miqtë dhe partneri janë të lumtur që ju kanë pranë.



DEMI

Bëni mirë të tentoni marrëveshje

jashtë shtetit sepse kanë më shumë mundësi financiare. Do të arrini ta bëni dallimin midis dy personave afër jush.



BINJAKËT

Sot, nëse tregoni gënjeshtria, do të

zbulohen shumë shpejt. Mundohuni të jeni të qartë në gjërat që ju nevojiten për një projekt.



GAFORRJA

Jeni në paqe me veten sot dhe me

personat që keni pranë. Bazohuni në informacionet që keni për të zgjidhur një çështje të komplikuar.



LUANI

Në sytë e njeriut të zemrës duhet

të jeni të përkryer dhe kjo ju bën të jeni sa më të vëmendshëm dhe në detaje ndaj vetes tuaj.



VIRGJËRËSHA

Jeni të ndrojtur dhe mjaft të

rezervuar në çfarëdo situatë që ju paraqitet sot. Temperamenti juaj nuk ju lejon të bëni eksperimente.



PESHORJA

Momente të shkuarës ju vijnë në

mendje, por pa qenë aq shumë thelbësore në vendimet tuaja të së tashmes. Një surprizë e këndshme do t'ju befasojë.



AKREPI

Megjithëse me buxhet të

reduktuar kohët e fundit, pasuria e brendshme është aq e bollshme sa ndiheni personi më i pasur në botë.



SHIGJETARI

Çdo gjë përreth jush

buzëqesh sot sepse edhe ju vetë i falni buzëqeshjet pa kërkuar asnjëherë asgjë në këmbim.



BRICJAPI

Miqësitë e reja do t'ju tregojnë që jeni

persona që te të tjerët përçoni veçse mirësi dhe energji pozitive. Kjo gjë do t'ju shoqërojë edhe në ambientin e punës.



UJORI

E kotë që përipieni të

fshiheni pas gishtit. Sot në çdo çast do të krijoni tensione që nuk janë shumë të nevojshme.



PESHQIT

Keni vendosur të jeni besnik të

ideve tuaja fillestare dhe do t'i mbronni ato pa bërë kompromise. Kjo gjë mund t'ju penalizojë në disa raste.

Jamie Foxx largohet bashkë me Sela Vave nga festa e ditëlindjes



Aktori i njohur Jamie Foxx ka mbushur 52 vjet. Ditëlindje e festoi në Warwick të Los Anxhelosit. Një burim për "Page Six", kishte deklaruar se aktori në këtë ndejë kishte hyrë bashkë me

Sela Vave, këngëtarën e re. Mediat e huaja raportojnë se ai është në lidhje të dashurisë me të. Po ashtu, i njëjti burim për "Page Six" ka thënë se ata janë parë duke dalë bashkë nga ndeja.

Nicole Scherzingeri dhe Thom Evans në lidhje dashurie



Ata kanë qenë të lidhur romantikisht, pavarësisht se Nicole Scherzingeri thotë se ajo është shumë e zënë për t'u lidhur me dikë. Por mund të ketë më shumë histori mes saj dhe Thom

Evansit teksa ishin fotografuar duke shikuar me admirim njëri-tjetrin në lokalit të koktejeve në Londër. Ndërsa dyshja qëndronte pranë barit, Thomi e shikonte me dashuri Nicolen.



Ava Max sjell këngën 'Salt'

Këngëtarja e njohur shqiptare, Ava Max, ka publikuar këngën e saj të re. Kënga më

e re quhet "Salt". "Salt" aktualisht është e disponueshme për publikim vetëm në versionin audio.

Selena Gomez, kokë e këmbë me Louis Vuitton



Selena Gomez duket se edhe xhinset duhet t'i ketë të markave të njohura që kanë çmime marramendëse. Këngëtarja 27-vjeçare e "Lose You to Love Me" është parë në Londër e veshur me xhinse dhe një xhaketë, po ashtu

nga materiali i xhinseve që në total veshja e saj kushton hiç më pak se 4 000 dollarë. Xhinset e Gomezit ishin të markës së njohur "Louis Vuitton" (1 280 dollarë), derisa edhe xhaketa ishte, po ashtu, nga marka e njohur franceze që kushton 2550 dollarë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Sokoli: Mbesin në Superligë me Flamurtarin



Bylbyl Sokoli që njihet si trajner "shpëtimtar" i skuadrave të rrezikuara nga rënia nga elita, të premtën është emëruar trajner i klubit të Flamurtarit nga Prishtina. "Profa" ka bërë me dije se me skuadrën kuqezi e synon mbetjen në IPKO Superligë. "Pas bisedave me drejtuesit e klubit kemi arritur një marrëveshje, me një qëllim që të gjithë me dhënë maksimumin në klub, që Flamurtari edhe këtë sezon ta sigurojë ekzistencën që është synim i im dhe i gjithëve në klub", ka thënë Sokoli

EPOKA ERE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Trajneri i dëshmuar në futbollin e Kosovës, Bylbyl Sokoli edhe zyrtarisht është emëruar trajner i skuadrës së Flamurtarit. "Profa" të premtën është prezantuar nga klubi kryeqytetas, kurse në këtë post e zëvendëson Sunaj Keçin. Ky i fundit e kishte zëvendësuar Artim Shaqirin që me shumë bujë e kishte marrë drejtimin e Flamurtarit para fillimit të këtij edicioni, por që me pas rezultatet e kësaj skuadre nuk ishin ato që u pritën nga ky klub. Drejtori i Përgjithshëm i klubit, Arbnor Morina beson se sezoni pranveror do të jetë i suksesshëm për klubin kuqezi. "Flamurtari ka arritur marrëveshjen me trajnerin e mirënjohur

Bylbyl Sokoli, i cili do ta udhëheq klubin tonë në gjysmëstatorin e dytë, por me mundësi vazhdimi për një kohë me të gjatë. Të gjithë besojmë se ky kampionat ka me qenë i suksesshëm për klubin tonë", ka thënë Morina. Ndërsa trajneri Bylbyl Sokoli, i cili në këtë edicion e kishte drejtuar klubin në pak ndeshje skuadrën e Prishtinës, ka thënë se marrëveshja mes tij dhe drejtuesve të Flamurtarit është arritur në mënyrë që të arrihen suksese në sezonin pranveror. Ai beson se Flamurtari do të mbetet pjesë e IPKO Superligës edhe për edicionin 2020/2021. "Pas bisedave me drejtuesit e klubit kemi arritur një marrëveshje, me një qëllim që të gjithë me dhënë maksimumin në klub, që Flamurtari edhe këtë sezon ta sigurojë ekzistencën që është synim i im dhe i

gjithëve në klub. Unë kam nderin të punojë një klub që ka traditë, që është themeluar dhe ka kaluar nëpër periudha shumë të vështira prej vitit 1968 e kënde, prandaj ky është motivi im kryesor", ka thënë Sokoli, i cili foli edhe për përforsimet e mundshme në afatin kalimtar të janarit. "Lojtarët që janë larguar do të zëvendësohen me lojtarë të kampionatit të Kosovës, para se gjithash do të mbështetem në forcat ekzistuese që janë prezent", ka shtuar Sokoli. Skuadra e Flamurtarit e ka përfunduar sezonin vjeshtor në vendin e nëntë me 19 pikë të grumbulluara, katër pikë më pak se skuadra e Trepçës '89 që është jashtë zonës së rënies nga mbijetesa. Nga 17 ndeshje të zhvilluara skuadra e Flamurtarit regjistroi pesë fitore, katër barazime dhe tetë humbje.

SHKURT

Gashi rikthehet në Zvicër

Sulmuesi shqiptar Shkëlzen Gashi do ta vazhdojë karrierën në futbollin zviceran. Gashi i kishte dhënë fund përvijës amerikane me ekipin Colorado Rapids ndërsa, sipas medieve zvicerane, nga 1 janari ai pritet t'i bashkohet ekipit të Aaraut. 31-vjeçari do t'i bashkohet projektit të klubit zviceran, i cili synon të rikthehet në elitën e futbollit zviceran. Gashi, dikur përfaqësues i Kombëtares shqiptare, një pjesë të mirë të karrierës e ka kaluar në Zvicër, ku e kishte arritur edhe kulmin, mbi të gjitha te Baseli. Ai pritet të nënshkruajë kontratë me klubin zviceran deri në verën e vitit 2023.

Berisha shënon sërish në Australi

Sulmuesi nga Kosova, Besart Berisha, ka vazhduar formën e mirë në kampionatin australian. Ai ka shënuar edhe një tjetër gol për skuadrën e tij Western United. Prishtinasi shënoi një gol mjaft të bukur në minutën e 41-të për 0-2. Ky ishte goli i pestë për Berishën këtë kampionat në elitën e futbollit australian.

Sot dhe nesër ndeshjet e fundit për këtë vit në hendboll

Trepça dhe Vëllaznimi takohen sot (e shtunë) në palestrën "Minatori" në Mitrovicë nga ora 20:00, në kryendeshjen e javës së 14-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Është kjo java e fundit për këtë vit, përkatësisht për pjesën e parë të kampionatit. Në ndeshjen e parë të luajtur në Gjakovë, Vëllaznimi e Trepça kishin zhvilluar lojë të fortë, ndërsa në fund fituan mitrovicasit me rezultat 32-31. Ndeshje e fortë e cilësore pritet edhe në Mitrovicë. Trepça është e treta me 18 pikë, kurse Vëllaznimi mban vendin e gjashtë me 12 pikë. Të shtunën është edhe ndeshja Besa Famgas-Drenica, që fillon në ora 19:00. Kampioni Besa Famgas ka fituar të gjitha 13 ndeshjet e deritashme dhe llogaritet favoriti i madh ndaj Drenicës që zë vendin e shtatë me 8 pikë. Besa udhëheq në tabelë me 26 pikë. Tri ndeshje të tjera janë të dielën: Vushtrria - Drita (18:00), Kastrioti - Prizreni (18:00), Prishtina-Llapi (15:00).

Lëndimi e lë pa medalje Akil Gjakovën

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Lëndimi i pësuar në gjysmëfinale ia ka mohuar luftën për medalje Akil Gjakovës në garën e Mastersit që po mbahet në Qingdao të Kinës. Xhudisti i Kosovës shënoi tri fitore në kategorinë - 73 kilogramë për t'u ndalur në

gjysmëfinale. Me pozitën e pestë sportisti më i mirë në Kosovë për vitin 2018 fitoi 648 pikë olimpikë. "Akili ishte në rrugë drejt suksesit më të madh në karrierën e tij. Ishte në ditën e përkryer duke mposhtur me Ippon gjer-

manin Zing, Rusin Mogushkov, mandej kinezin Sayinjrigala për të ardhur në gjysmëfinale me Kampionin Botëror Hashimoto e kur ishte duke luftuar shumë mirë gjatë një tentimi të japonezit pësoi një lëndim në bërryl dhe u desh ta

ndërpriste meçin. Fat i keq për Akilin. Shpresoj që lëndimi do t'i kalojë shpejt! Akili nuk do të mund të luftojë as për medalje të bronzitë, ku do të duhej të ndeshesh me Azerin Orujov", ka shkruar Kuka në llogarinë e vet në "Facebook".



Feronikeli prezanton Ilir Berishën

Drenas, 13 dhjetor - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Feronikeli, e ka prezantuar transferimin e ri Ilir Berisha. Futbollisti Berisha do t'i mbrojë ngjyrat e klubit nga Drenasi në sezonin pranveror.

Ai rikthehet në futbollin e Kosovës, pas përvojës së marrë në arenën ndërkombëtare. "Ai luan në pozitën e qendërmbrojtësit, njihet si futbollist me karakter luftarak dhe i fuqishëm, duke i dhënë

kështu edhe më shumë stabilitet mbrojtjes së FC Feronikelit. Ai ka qenë pjesë e Orebro, Gefle, Flamurtarit të Vlorës e, së fundmi, te Vasteras. Kujtojmë që Berisha më parë ishte grumbulluar

nga Kombëtarja e Shqipërisë, ndërsa ka edhe disa ndeshje me Kosovën. 28-vjeçari ishte ndër lojtarët kyç të Kosovës para pranimit në UEFA e FIFA", thuhet në njoftimin e FC Feronikeli.



Kryendeshja në kryeqytet

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 17-të në Superligën e Kosovës në basketboll, që pritet të jetë shumë interesante. Ndeshja kryesore e kësaj xhiroje do të zhvillohet në kryeqytet ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Bashkimit. Të dy skuadrat kanë grumbulluar nga 25 pikë apo nga 11 fitore dhe tri humbje deri më tani, andaj përballja pritet të jetë shumë interesante. "Bardhekaltrit" hynë në këtë përballje pas një serie prej gjashtë fitoreve radhazi, kurse prizrenasit kanë treguar lojëra dhe rezultate të mira këtë edicion, duke qenë në krye të renditjes. Në sfidën e parë në Prizren ndërmjet këtyre dy skuadrave në këtë edicion, kishin



fituar prizrenasit me rezultat 95:89. Rahoveci që, po ashtu, ka grumbulluar 25 pikë, do të përballlet me Ponte Prizrenin, në një takim mjaft interesant. Prizrenasit kanë grumbulluar 23 pikë por, gjithashtu, kanë edhe një ndeshje më shumë të zhvilluar. Takim mjaft interesant pritet të jetë edhe ai ndërmjet Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Pejanët kanë shtatë fitore dhe shtatë humbje, kurse therandasit kanë dhjetë fitore dhe katër humbje, e fundit ishte nga Sigal Prishtina që ndër-

preu serinë e Yllit prej gjashtë fitoreve radhazi. Dueli i fundit, por shumë i rëndësishëm, është në mes të Feronikelit dhe Trepçës. Skuadra nga Drenasi ka 18 pikë, kurse ajo mitrovicase 16, duke u renditur në vendin e shtatë, përkatësisht të tetë. Pikërisht kjo e bën duelin shumë të veçantë, sepse dy skuadrat synojnë të mbesin në elitë. Lipjani pushon këtë xhiro. Në këtë edicion dy ekipet e fundit (vendi 8 dhe 9) bien nga Superliga, kurse vendi i shtatë do të luajë në "play-out".

SUPERLIGA - JAVA 17

Të shtunën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Bashkimi
19:00 Ponte Prizreni - Rahoveci

Të dielën takohen:
17:00 Peja - Golden Eagle Ylli
19:00 Feronikeli - Trepça

Dallasi mposhti Detroitin



DETROIT, 13 DHJETOR - Skuadra e Dallasit ka arritur një fitore të rëndësishme ndaj Detroitit me shifrat 122-111. Dy skuadrat e NBA-së kanë zbarkuar në Mexico City dhe kanë dhuruar spektakël për shikuesit. Më i miri në fushë ishte Donçiq, që realizoi një "triple double", autor i 41 pikëve, 12 reboundeve dhe 11 asistimeve. Ai vendosi rekordin e lojtarit të parë në historinë e NBA-së që realizon një "triple-double" në një ndeshje që luhet jashtë

Amerikës dhe Kanadasë. Fiton edhe skuadra e Denverit, që mundi 114-99 Portlandin dhe qëndron në grupin e ekipeve pretendente në Perëndim. Grant dhe Jokiç realizuan nga 20 pikë për Denverin në këtë sukses. Jashtë fushës triumfon ekipi i Philadelphias, që mundi me rezultat 115-109 Bostonin, sfidë me rivalitet dhe emocione. Për mysafirët u dalluan Embiid me 38 pikë e 13 rebounde si dhe Harris me 23 pikë. Skuadra e

Clevelandit, falë 30 pikëve e 17 reboundeve të Love si dhe 28 pikëve të Sexton, mundi 117-109 San Antonio, një përballje mes dy ekipeve që këtë sezon po zhgënjnë në kampionat.

REZULTATET

Boston - Philadelphia	109-115
San Antonio - Cleveland	109-117
Detroit - Dallas	111-122
Denver - Portland	114-99

SHKURT

UEFA dënon Turqinë

Turqia ka siguruar kualifikimin në "Euro 2020" në grupin në të cilin ishte edhe Kombëtarja e Shqipërisë. Por, ndeshjet ndaj Shqipërisë dhe ndaj Francës, e para e fituar dhe e dyta e luajtur baras në minutat e fundit, ishte bërë temë diskutimi. Në këto dy takime futbollistët e Turqisë kanë festuar golat me nderime ushtarake, e gjitha kjo duke nderuar ushtarët turq, që luftonin në Siri dhe vende kurde. Tashmë UEFA për këtë lloj festimi ka marrë edhe një masë ndëshkuese për këtë kombëtare. Vetëm 50 mijë euro është dënimi që u është dhënë turqve nga shtëpia më e madhe e futbollit në Evropë.

Ronaldinho: Messi është më i miri i kohës së tij

Ish-ylli i Barcelonës, Ronaldinho, nuk dëshiron që ta krahasojë Lionel Messin me Pelen dhe Maradonën. Brazili Ronaldinho mendon se argjentinas mund të cilësohet vetëm si lojtari më i mirë i gjeneratës së tij. "Unë nuk mund të them se Messi është lojtari më i mirë ndonjëherë, por ai është më i miri i kohës së tij", ka thënë Ronaldinho.

Coman mungon tri javë

Kingsley Coman u lëndua në ndeshjen e Ligës së Kampionëve që Bayern Munchen e fitoi kundër Tottenham Hotspur me rezultat 3-1. 23-vjeçari është zëvendësuar në pjesën e parë të ndeshjes, por lëndimi i tij nuk është aq serioz sa mendohej. Pas ekzaminimeve mjekësore u vërtetua se futbollisti francez do të mungojë vetëm tri javë.

Kloppi në Liverpool deri më 2024

Trajneri Jurgen Klopp ka nënshkruar kontratë të re pesëvjeçare me Liverpoolin, që do ta mbajë atë te klubi anglez deri në vitin 2024. Kontrata paraprake e 52-vjeçarit me "Reds" do të skadonte në vitin 2022, mirëpo Kloppi tashmë e ka bërë të qartë dëshirën për të vazhduar edhe më tutje në kampionin e Evropës. Ky lajm u bë i ditur nga faqja zyrtare e Liverpoolit të premtën, për të cilën Kloppi shprehu lumturinë e tij me këtë marrëveshje të re. "Për mua personalisht, kjo e deklaroi qëllimin tonë, që është i ndërtuar nga dijenia ime për atë që e kemi arritur deri më tani, si partnerë, dhe nga ajo që e kemi tani për të arritur suksese edhe më tutje", ka thënë Kloppi. "Kur unë e shoh zhvillimin e klubit dhe punën e përbashkët që po e bëjmë, unë ndiej se kontributi im vetëm mund të shtohet. Njerëzit e shohin atë që ndodh në fushë si matje për progresin tonë, por ky s'është matësi i vetëm", ka shtuar Klopp.

Wozniacki: Pas Australian Open do të tërhiqem nga sporti

Tenistja daneze Caroline Wozniacki, ish-numri 1 në botë për femra (në tetor 2010), ka deklaruar se pas grand slamit të Australian Open do të tërhiqet përfundimisht nga sporti. "Kam luajtur si profesioniste që kur isha 15 vjeçe dhe kjo periudhë ka përfaqësuar një kapitull të rëndësishëm të jetës time. Kam fituar 30 trofe, kam qenë numri 1 në botë për 71 javë, kam fituar Australian Open në vitin 2018 dhe kam marrë pjesë në tri Olimpiada. Pra, realizova gjithçka kisha ëndërruar", ka thënë Caroline Wozniacki. Tenistja 29-vjeçare daneze e konfirmoi largimin përmes një postimi në "Instagram" dhe lamtumira do të vijë në turneun e vetëm Slam që ka fituar në karrierë.



Komuna Shtërpçë

Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Nr. prot.. 08-030/01-18213/19

Data: 13.12.2019

Bazuar në Ligjin për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 35; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, neni 5; Ligjin e Punës nr.03/L-212, neni 8; Udhëzimin Administrativ 10/2018 dhe 05/2015, Neni 6 (MASHT), Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpallë:

KONKURS

Një mësimdhënës lëndor në shfmu. "Osman Mani" në Firajë.

Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe

Norma e plotë

Paga bazë €: 421

Kohëzgjatja e kontratës: 02.09.2021

DETYRAT KRYESORE

Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies. Të përgatis me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me Kurrikulën e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi.

Të ketë njohuri për një repertuar të gjerë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje t'i aplikoj ato që më së miri i përgjigjen situatës në klasë. Të shfrytëzojë në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion. Të planifikoj, të udhëhojë dhe të vëzhgojë nxënëcin dhe sjelljen e secilit nxënës.

Të zbatoj metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare. Të krijoj një atmosferë pune dhe discipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit ndaj nxënësve. Të kontrolloj me rregull dhe të mbaj evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënës si dhe të jetë në gjendje t'i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejt për progresin e arritur të nxënësit sipas kërkesës.

Të zgjoj te nxënësit kureshtjen për të nxënë dhe t'i inkurajoj ata të nxënë në mënyrë të pavarur.

Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit. Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e çdo nxënësi duke realizuar takime individuale me prindër/ kujdestarë të fëmijës.

T'i ndihmojë kolegët për ngritjen e cilësisë së punës.

Të mbikëqyrë dhe të udhëzojë nxënësit në procesin mësimor.

Të marrë pjesë në punën e organeve të shkollës.

Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës.

Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtëmësimore me nxënës dhe kryej me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës.

Të tregoj respekt, sjellje kolegjiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon.

Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.

I punësuar i është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar në rregullorën e brendshme të shkollës.

Kushtet e konkursit:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas **UA. nr. 05/2015 (MASHT)**

Dokumentet e nevojshme për konkurim:

- Diploma
- Certifikata e lindjes
- Letërnjoftimi
- Vërtetim nga gjykata, me të cilin dëshmohet se kandidati nuk është nën hetime.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar.

Fletëaplikacionet mirren në DKA ose në shkollë dhe dorëzohen (me dëshmi të verifikuara të kualifikimeve) në objektin e Komunës së Shtërpçës, zyra nr. 28

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Bajram Curri" vendi Romaje**

Komuna: **Prizren**

Data: **07.12.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës: Trajnim
ESIP/SDG/82 – CS/1.3	Puna e kujdestarit te klases-kujdestari i mire

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren. Objektiv i nën-komponentit 1.2. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktivitetëve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënies

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren, më së largu deri më datën: 17.12.2019 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Refki Demaj

Telefoni: 044/113196

E-mail: refki-demaj@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shpall te Pavlefshëm Certifikatën e Biznesit te Kompanisë Slovene Healthcare Cluster L.L.C me nr 70507064 dhe Certifikatën e nr Fiskal me: 600453609.
- ▶ "IDEA-A" N.T.SH. ofron zbritje të madhe subjekteve afariste nga stoku i mallit për shkak të mbylljes së biznesit.
- ▶ Muhamed Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Fadil Hisari" Prizren.
- ▶ Bekim Piraj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Mamudije Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Fadil Hisari" Prizren
- ▶ Ruzhdi Avdullahu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Cener Beksac shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Matilo Goreci" Prizren.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poloprivredje,
Šumarstvai Seoskog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural
Development

Departamenti i Prokurimit/Departament Nabavke/Departament of Procurment

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK PËR SHITJEN E DEMAVE

Numri referues i shitjes: 203-019-023-231

Datë: 12.12.2019

NENI I: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Artan Jaha		
Adresa postare: "Ukshin Hoti", Nr.120 kati 6, Lakrishtë Prishtinë.		
Qyteti: Prishtinë	Kodi postarë: 10000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Artan Jaha		Telefoni: 038/211-38/447
Email: artan.jaha@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e faqes së internetit (nëse është e aplikueshme):		

NENI II: LËNDA E SHITJES

Shitja e Demave për therje.

Dema për therje të shkarkuar nga humbja e aftësisë së riprodhimit shiten në kushte "siç janë" dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë përgjegjësi të mëtutjeshme pas shitjes.

Përshkrimi i aseteve	Gjendja shitjes	Viti i blerjes	Sasia	Vlera fillestare	Përafërsisht pesha e gjallë e demave
Dema	Dema të shkarkuara nga riprodhimi	2012	4	1 € / kg, pesha e gjallë	700/850

NENI III: INFORMATA ADMINISTRATIVE

Ankandi do të mbahet në Prishtinë: Rr. "Ukshin Hoti" Nr. 120 Kati 6, Lakrishtë-Prishtinë.

Ofertuesit e interesuar mund të inspektojnë Demat në Qendrën Gjenetike në Vitomeriç/Pejë çdo ditë pune nga data 13.12.2019 deri me 19.12.2019 nga ora 10:00 deri 14:00, personi kontaktues Adil Maloku, tel: 044-364-409; 049-100-922

Kriteret vijuese që do të kërkohen për vlerësimin e ofertave janë:

- Çmimi më i lartë i ofruar nga çmimi bazë,
- Certifikata e biznesit,
- Certifikata e Numrit Fiskal,
- Licencë nga AUV.

Afati i fundit për kërkesa për pjesëmarrje në ankand është deri më 18.12.2019 ora 16:00

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është më datë: 20.12.2019 ora 14:00. Ofertat duhet të dorëzohen në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, adresa Rr. "Ukshin Hoti" Nr.120, Prishtinë në Zyrën e Prokurimit, kati 6.

Hapja e ofertave do të bëhet në Zyrën e Prokurimit me datë 20.12.2019 ora 14:30.

Asetet do t'i shiten ofertuesit që ofron çmimin më të lartë, si dhe i plotëson kriteret administrative. Ofertuesi i suksesshëm do të shpallet pas vlerësimit të ofertave.

Të drejtë ofertimi kanë vetëm personat juridik të cilët i plotësojnë kriteret e lartëshënuara.

Të gjitha palët e interesuara duhet të bëjnë kërkesë për tërheqje të Dosjes në emailin: Artan.Jaha@rks-gov.net tel: 038/200-38-447.

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit, sipas dispozitave të Kapitullit IX të Ligjit Nr. 04/L-042, Ligji mbi Prokurimin Publik në Kosovë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poloprivredje, Šumarstvai Seoskog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development

Departamenti i Prokurimit/Departament Nabavke/Departament of Procurment

OBAVEŠTENJE ZA JAVNU AUKCIJU ZA PRODAJU BIKOVA

Referentni broj prodaje: 203-019-023-231

Datë: 12.12.2019

ČLAN I: IME I ADRESA UGOVORENOG AUTORITETA (UV)

Zvanično ime: Artan Jaha		
Poštanska adresa: Ukshin Hoti, br.120 Sprat 6 Lakrisht Prishtina.		
Grad: Priština	Poštanski kod: 10000	Dražava: Kosovo
Kontakt: Artan Jaha		Telefon: 038/211-38/447
Email: artan.jaha@rks-gov.net		Faks:
Adresa internet stranice (ako je primenljivo):		

ČLAN II: PREDMET PRODAJE

Cilj ugovorenog autoriteta jeste prodaja bikova putem javne aukcije.

Bikovi za klanje oslobođeni od sposobnosti reprodukcije se prodaju pod uslovima "kao što su, gde su" i ugovoreni autoritet neće biti dalje odgovorni nakon prodaje.

Opis sredstava	Prodajno stanje	Godina nabavke	Količina	Početna vrednost	Približna živa težina bikova
Bikovi	Bikovi oslobođeni od reprodukcije	2012	4	1 € / kg, žive mase	700/850

ČLAN III: ADMINISTRATIVNE INFORMACIJE

Aukcija će se održati u Prištini: Ukskina Hoti br. 120 Sprat 6, Lakrisht - Priština
Zainteresovani ponuđači mogu pregledati Demat u Genetskom centru u Vitomeriçu / Peći svakog radnog dana od 13.12.2019 do 19.12.2019 od 10:00 do 14:00, kontakt osoba Adil Maloku, tel: 044-364-409; 049-100-922

Sledeći kriterijumi koji će se zahtevati za procenjivanje ponuda su:

- Najviša ponuđena cena od osnovne cene;
- Uverenje o poslovanju;
- Uverenje o fiskalnom broju;
- Licenca iz AHV-a.

Rok za podnošenje zahteva za učešće na aukciji je 19.12.2019 do 16:00

Rok za podnošenje ponuda je: 20.12.2019 do 14:00 časova. Ponude se moraju dostaviti u Ukshin Hoti ul. Br.120 Prištinska kancelarija Lakrisht, 6. sprat u Ministarstvu poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja.

Ponude će biti otvorene u kancelariji za nabavke 20.12.2019 u 14:30

Imovina će biti prodana najvišem ponuđaču i ispunjavat će administrativne kriterijume. Uspešni ponuđač biće objavljen nakon procene ponude.

Samo pravna lica koja ispunjavaju gore navedene kriterijume imaju pravo na ponudu.

Sve zainteresovane strane treba da se prijave za preuzimanje mape u e-pošti; Artan.Jaha@rks-gov.net Tel; 038 / 200-38-447

Svaka zainteresovana stranka ima pravo žalbe pri nabavnom organu za razmatranje, shodno odredbama poglavlja IX zakona br. 04/L-042, Zakon za javnu nabavku na Kosovu.

SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net